



1.29358 USD

135.916 LEKE

0.845094 GBP

1.35890 CHF

112.121 JPY

1.48927 AUD

1.36800 CAD



BISEDË ME VALDET GJINOVCIN

Produktet pa afat kërcënojnë shëndetin

>>>4



EKONOMI

Kosova, vend i përshtatshëm për pastrim parash

>>>3



EKONOMI

Anëtarësimi në OBT, proces i largët

>>>5

NE BRENDESI

Fiskalizohen 550 biznese

Procesi i fiskalizimit në Kosovë është duke u zhvilluar dhe, deri më tani, vetëm nga grupi i parë i Njësisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj (NJTM) është arritur të fiskalizohen afër 90 për qind të bizneseve dhe rreth 40 për qind...



>>>9

Prokurimi po i ngadalëson donacionet

Ahmet Shala, ministër i Ekonomisë dhe Financave, thotë se procesi i arkave fiskale edhe në vendet në zhvillim ka zgjatur prej 3 deri në 15 vjet.

"ATK-ja ka bërë një punë mjaft të mirë me numrat fiskalë. Këtu është një hallkë e gjitha...

>>>14

"Besa Security" me shtrirje në tërë Kosovën

Kompania e Sigurimit "Besa Security" është njëra ndër kompanitë më të mëdha në Kosovë e cila ofron shërbime cilësore dhe kualitative për klientelen e saj si në aspektin fizik, teknik ashtu...



>>>18

Safet Gërzhaliu, kryetar i OEK-ut

Me 52 vota pro dhe vetëm 1 votë kundër, Safet Gërzhaliu është zgjedhur të premtën kryetar i ri i Odës Ekonomike të Kosovës



>>>12-13

Marketing



Reklamoni biznesin tuaj në

Gazeta e vetme dy javore e specializuar për ekonomi dhe biznes.

ekoBiznesi

KJO ËSHTË RRUGA MË E SIGURT PËR AFIRMIMIN E BIZNESIT TUAJ.



Shkruan: Ibrahim Rexhepi

Rishikimi i problemeve

Janë të qarta problemet në të cilat ka hyrë buxheti i Kosovës. Qeveria duhet të shesë të gjitha pasuritë që ka, të rrisë ngarkesat tatimore dhe të nxisë ngritjen e çmimeve, të shpenzojë të gjitha paratë nëse diku i kanë mbetur si teprica, ashtu që të financojë autostradën Vërmicë-Merdarë

Duhet të ndërtohet autostrada Vërmicë - Merdarë! Me çdo kusht! Por, qeveria nuk duhet të sillet me kokëfortësi ndaj këtij projekti. Ende ka mundësi që të analizojë se kah po e udhëheq buxhetin e Kosovës dhe investimet në segmentet e tjera. Të vlerësojë se mos po e futë Kosovën në krizë dhe mos po i ngarkon tatimpaguesit, respektivisht konsumatorët, me barrë të papërballueshme. Rishikimi i buxhetit të vitit 2010 dëshmoi se vështirësitë janë të pashmangshme. Ndërkaq, se sa thellë po futet në krizë buxheti i Kosovës, kryesi i punëve nuk e ka dert. Ai, tash e ka në dorë çekun prej 130 milionë eurosh, sa është kontraktuar segmenti i parë. Me një fjalë, nga ky pozicion nuk ka kthim prapa.

Pa marrë parasysh reagimet, mospajtimet dhe kundërshtimet, segmenti i parë i tij, ai nga Vërmica deri në Duhel do të përfundojë. Të mbajmë shpresën se në verën e vitit të ardhshëm, ky segment do të jetë i përfunduar, dhe nuk do të kushtojë më shumë se 130 milionë euro, sa është kontraktuar kjo punë me konsorciumin "Bechtel & Enka".

Buxheti i rishikuar, të cilin qeveria e prezantoi në Kuvendin e Kosovës, por edhe debatet e zhvilluara, kanë identifikuar se projekti nuk do të jetë i lehtë. Kosovarët, që nga korriku, do të përballen me koston e autostradës. Qeveria duhet të shesë të gjitha pasuritë që ka, të rrisë ngarkesat tatimore dhe të nxisë ngritjen e çmimeve, të shpenzojë të gjitha paratë nëse diku i kanë mbetur si teprica, ashtu që të financojë autostradën Vërmicë-Merdarë. Ajo ka planifikuar që të hyrat në buxhet të rriten edhe për 83 milionë euro, apo aq sa para i kanë munguar për të mbuluar çekun që është dashur t'ia jep kompanisë implementuese. Ndërkaq, shpenzimet rriten për 93 milionë euro, përkatësisht, nga një miliard e 157 milionë euro, shkojnë në një miliard e 254 milionë euro. Po sipas dokumentit të qeverisë, deficitit i përgjithshëm shkon, nga 212 milionë euro, në 218 milionë euro. Por, pa marrë parasysh disa korigjime të lehta që janë bërë në paga dhe shpenzime të tjera, ngritje më të madhe shenojnë investimet kapitale, nga 414 milionë euro, në 494 milionë euro. Pa marrë parasysh këtë rritje, posaçërisht nga komunat ka ankesa se u është imponuar të bëjnë reduktimin e projekteve, ashtu që të mbesin më shumë para për infrastrukturën rrugore, apo për të financuar rrugën e kombit. Kjo vërehet qartë edhe nga pasqyrat buxhetore. Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit ka një buxhet prej 215 milionë eurosh, prej të cilave 202 milionë euro janë destinuar për investime kapitale. Për ndërtimin e autostradave (si shkruan në dokument) janë rezervuar 123 milionë euro. Pa marrë parasysh relokimin që është përdorur në këtë dokument, është e qartë se të gjitha kalkulimet janë bërë për të gjetur mundësi që të financohet projekti më i madh që ndonjëherë është realizuar në Kosovë. Ndonëse nuk mund të vihet në dyshim rëndësia e tij, por qeveria e ka pasur obligim t'u tregojë

kosovarëve se ata duhet të përballen me barrën e këtij investimi. Ata duhet të sigurojnë para, meqenëse, sipas zhvillimeve të deritashme, asnjë institucion financiar ndërkombëtar nuk ka shfaqur interesimin të japë para për këtë projekt. Por, edhe nëse ndodh që në të ardhmen të merret ndonjë kredi, atëherë ajo do të shlyhet me paratë e tatimpaguesve. Dhe, në këtë situatë, qeveria nuk ka shumë alternativa. Sa për fillim ka zgjedhur një variant që më pak sjell dhimbje. Ka bërë disa shkurtime, përkatësisht ka reduktuar listën e qëllimeve për investime dhe ka shtuar ngarkesën fiskale për një kategori të mallrave. Tash, cigaret, karburantet dhe disa artikuj të tjerë "të luksit" do të kushtojnë më shtrenjtë, për shkak të rritjes së akcizës. Nga ana tjetër, një numër i madh i kompanive kundërshtojnë pse duhet të paguajnë çmim më të lartë për shfrytëzimin e mineraleve në Kosovë. Që të siguroj para, qeverisë i është dashur ta rrisë këtë taksë, përkatësisht taniemën. Por, ky është çmimi i këtij investimi.

Kundërshtimet dhe mospajtimet u tejkaluan me një votim në Kuvendin e Kosovës. Buxheti i rishikuar tash ka versionin përfundimtar dhe pritet dekretimi nga presidenti. Edhe këtu do të kalojë pa ndonjë problem. Por, çfarë mund të ndodhë në dy vitet e ardhshme kur për autostradën duhet siguruar edhe 570 milionë euro, bazuar në koston që ka prezantuar MTPT-ja. Prej nga do të sigurohen paratë?

Këtu është vështirë të gjendet përgjigje, meqenëse, sipas dokumenteve të Ministrisë së Financave, deri në vitin 2013, shpenzimet buxhetore do të rriten më shpejt se të hyrat. Ndërkaq, rritja më e madhe do të ndodhë të shpenzimet kapitale, të cilat, nga 495 milionë euro, sa janë shtjet, në mot shkojnë në 611 milionë euro, ndërsa, pas dy vitesh, në 650 milionë euro. Ato fillojnë të bien në vitin 2013 dhe ky zhvillim reflekton ritmin e punëve që do të bëhen në autostradë. Ajo duhet të përfundojë pas 36 muajve, përkatësisht më 2013. Por, është një detaj interesant, përdërisa shtjet investimet kapitale në totalin e shpenzimeve marrin pjesë 39,5 për qind, në mot shkojnë në 42,9 për qind, ndërsa në vitin 2013 do të ndodhë një rënie e lehtë - 42,7 për qind. Vështuar nga aspekti makroekonomik, proporcionet e këtilla duhet të reflektohen pozitivisht në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Por është vështirë që të ndodhë kjo, meqenëse, shuma më e madhe investimeve do të fokusohen në një projekt, i cili ka koston e lartë, kurse ndikimi i tij në nxitjen e zhvillimit të degeve të tjera, apo në rritjen punësimit është i kufizuar. Nga ana tjetër, ai do të detyrojë qeverinë që të shesë të gjitha pronat që ka. Me këtë, ajo është pajtuar të heqë dorë nga paratë që i sjellin kompanitë publike, ndoshta edhe të përballen me tensione sociale, vetëm që të sigurojë para për autostradën.

(Autori është redaktor i shtojcës për ekonomi në gazetën "Zëri". Teksti është shkruar enkas për "EkoBiznes")



KOSOVA, VEND I PËRSHTATSHËM PËR PASTRIM PARASH	3
BISEDË ME KRYESHEFIN EKZEKUTIV TË AVUK-UT, VALDET GJINOVICIN	4
ANËTARESIMI NË OBT, PROCES I LARGET	5
PRIVATIZIMI I KEK-UT NUK SJELL HUMBJE TË VENDEVE TË PUNËS	6
PALLATI NË MJEGULL	7
BIZNESET KERKOJNË FALJE TË NDËSHKIMEVE	8
FISKALIZOHEN 550 BIZNESE	9
MARKETING	10
BIZNESET INVESTOJNË PAK NË MARKETING	11
SHUHEN 1100 BIZNESE	11
SAFET GËRXHALIU, KRYETAR I OEK-UT	12-13
PROKURIMI PO I NGADALESON DONACIONET	14
SHTRENJTOHET ARI, BIE SHITJA	14
RRETH 1 MILION EURO NGA AKCIZA E KAFES NË ARKËN E SHITIT	15
MARKETING	15
MARKETING	16
ZHVILLIMI I ARBITRAZHIT NË ODËN EKONOMIKE TË KOSOVËS	17
'BESA SECURITY' ME SHTRIRJE NË TËRË KOSOVËN	18
RRITEN ÇMIMET E PATUNDSHMËRIVE	19
FEMRAT, TË BARABARTA ME MESHKUJT	20
MARKETING	21
MARKETING	22
RENDIMENTE TË ULËTA TË GRURIT	23
VAZHDON SHKATËRRIMI PYJEVE	24
MARKETING	24

ekoBiznesi

Botues: Oda Ekonomike e Kosovës në bashkëpunim me Qendrën e Gazetarëve të Ekonomisë të Kosovës

Drejtor: Berat Rukiqi

Redaktohet nga Kolegjiumi i Redaksisë



Kontakt: Adresa
"Nëna Tereze" 20, Prishtinë



Tel:
038 223 626



Email:
ekobiznesi@gmail.com



Kosova, vend i përshtatshëm PËR PASTRIM PARASH



Dukuria e pastrimit të parave thuhet se është e shprehur edhe në Kosovë.

Ekspertë të ekonomisë thonë se kjo dukuri do t'i kushtojë shtrenjtë imazhit të vendit, si në aspektin ekonomik, po ashtu dhe në procesin e integriteteve evropiane



Luljeta Krasniqi - Veseli



Njohës të çështjeve ekonomike dhe të sigurisë theksojnë se dukuria e pastrimit të parave në Kosovë është e pranishme, ndërsa përpjekjet për luftimin e kësaj dukurie janë tejet të pamjaftueshme. Kosova, sipas tyre, është vend i përshtatshëm për shpëlarje parash, sikurse vendet e tjera që janë në proces të tranzicionit politik dhe ekonomik.

Përgjegjësia e ulët institucionale

Eksperti për çështje ekonomike, Safet Gërxhaliu, thotë se në vendet ku përgjegjësia e institucioneve është e nivelit më të ulët, mundësia e këtij fenomeni për t'u zbatuar është më e madhe.

"Ajo çka e karakterizon Kosovën dhe

vendet e tjera në këtë aspekt, është se në këto transaksione të shpëlarjes së parave janë të involuara instanca më të larta. Për këtë arsye, prokuroria dhe fjala e gjyqësorit në Kosovë duhet të kenë një peshë më të madhe dhe tek në këtë mënyrë do të parandalohet dhe luftohet një dukuri e tillë", thotë Gërxhaliu.

Gërxhaliu shpjegon se pastrimi i parave sjell jostabilitet në të gjitha rajonet, qofshin ato vende të zhvilluara, ose vende në zhvillim. Ndërsa, luftimi i kësaj dukurie, sipas tij, është përgjegjësi institucionale.

"Është një dukuri, e cila Kosovës do t'i kushtojë shumë shtrenjtë, në radhë të parë në aspektin e reputacionit; në rend të dytë, për arsye të favoreve negative apo favoreve që iu bëhen atyre që nuk e meritojnë një favor të tillë dhe e tërë kjo do ta dëmtojë

edhe më tepër imazhin e Kosovës edhe ashtu të dëmtuar, si në procesin e aspektit ekonomik, po ashtu edhe në procesin e integriteteve evropiane", thekson Gërxhaliu.

Mandatar i kryesor për luftimin e pastrimit të parave në Kosovë është Qendra e Intelgjencës Financiare, qendër kjo që deri para dy javësh ka qenë nën mandatin e EULEX-it, ndërsa tash kompetencat kanë kaluar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Me këtë rast, zyrtarë qeveritarë kishin theksuar se institucionet e Kosovës janë të përgatitura për luftimin e të gjitha veprave që kanë të bëjnë me shpëlarje parash dhe financim të terrorizimit.

15 të dyshuar për pastrim parash

Artan Nimani, profesor në

Universitetin e Prishtinës, mendon se bartja e kompetencave nga autoritetet ndërkombëtare tek ato vendore do të ndikojë më tepër në kontrollimin e parave të dyshimta "Qeveria dhe kryeministri i Kosovës nuk kanë pasur informacione se çka është duke ndodhur me paratë e pista, sepse ato i ka pasur EULEX-i dhe ne i dimë se cilat janë të drejtat e rezervuara. Unë jam i interesuar që vërtet të ketë një kontroll financiar të mirëfilltë, që të kemi një sistem bankar të qëndrueshëm. Unë jam shumë i interesuar që në Kosovë të kontrollohen paratë e pista dhe të garantohen paratë e ndershme", shprehet Nimani.

Se kjo dukuri është e pranishme në Kosovë, e pohojnë edhe zyrtarë në Policinë e Kosovës. Sabrije Kamberi, zëdhënëse në këtë institucion, thek-

son se dukuria e pastrimit të parave është e shprehur, por jo në numër shumë të madh. "Policia e Kosovës, në raste të tilla, pranon informacione nga burime të ndryshme dhe çdo informata trajtohet në mënyrë të plotë dhe profesionale, dhe nëse gjenden dyshime, fillohen hetime në konsultim me Prokurorinë". "Rastet e pastrimit të parave janë raste komplekse dhe si të tilla mund të fillojnë nën dyshimin se janë raste të pastrimit të parave. Por, më vonë dalin se janë raste të përfittimit joproporcional, ose shmangie nga tatimi", deklaroi Kamberi.

Në anën tjetër, sipas statistikave të Policisë së Kosovës, në vitin 2009, Njësia e Hetimeve Financiare ka punuar në pesë raste të pavarura, ku kanë qenë të përfshirë rreth 15 të dyshuar.

BISEDË ME KRYESHEFIN EKZEKUTIV TË AVUK-ut, VALDET GJINOVCI



Valdet Gjinovci

Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit të Kosovës (AVUK), gjatë këtij viti, ka asgjësuar mbi 160 tonë mish me afat të skaduar, ose të pasigurt për konsum nga popullata, i cili është hasur tek operatorët e bizneseve me ushqim në territorin e Republikës së Kosovës. Ushtruesi i Detyrës së Kryeshefit të Agjencisë së Veterinës dhe Ushqimit të Kosovës (AVUK), Valdet Gjinovci, ka thënë se sasia më e madhe e mishit që importohet në Kosovë vjen nga Brazili

Eko Biznesi

Ushtruesi i detyrës së kryeshefit të Agjencisë së Veterinës dhe Ushqimit të Kosovës, (AVUK), Valdet Gjinovci ka thënë se, gjatë mandatit të tij, nuk do të lejohet që të tregtohet mish dhe produkte mishi i pasigurt për shëndetin e popullatës në nivel vendi. Sipas tij, AVUK-u do të fokusohet në inspektimin e të gjitha produkteve ushqimore të cilat importohen, me theks të veçantë mish dhe produktet e mishit. Gjinovci e pranon se ka trashëguar shumë probleme në këtë institucion, por ka theksuar se nuk do të ketë mëshirë ndaj atyre që e shkelin ligjin, madje as ndaj nëpunësve të Agjencisë së Veterinës dhe Ushqimit që nuk i respektojnë rregullat e shërbimit civil të Kosovës.

160 tonë mish të asgjësuar

Nga marrja e detyrës e deri më tani, Gjinovci ka asgjësuar mbi 160 tonë mish me afat të skaduar ose të pasigurt për konsum nga popullata, i cili është hasur tek operatorët e bizneseve me ushqim në territorin e Republikës së Kosovës. Sipas tij, problemi i therjes së kafshëve nëpër tregje është problem shqetësues dhe është një nder prioritetet e punës për tejkalimin e kësaj gjendje ne afat sa më të shkurtër kohor. "Jemi duke punuar me një entuziazëm, për arsye se siguria e ushqimit lidhet edhe me sigurinë shëndetli të qytetarëve dhe nuk do të lejojmë abuzimet me produkte ushqimore nga ana e operatorëve të biznesit me ushqim. Për të gjitha abuzimet e hasura nga autoriteti kompetent, ndaj operatorëve do të iniciohen procedurat në gjykatat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi" tha ai. Gjinovci ka treguar se AVUK-u do bëjë rritjen e numrit të inspektimeve tek të gjithë operatorët e biznesit me ushqim, duke filluar nga importuesit, përpunuesit, prodhuesit dhe pikat e tregimit të produkteve finale.

Produktet pa afat rrezikojnë shëndetin

Tek të gjithë operatorët e biznesit që hasen produkte ushqimore të pasig-

Produktet pa afat kërcënojnë shëndetin



urta për konsum, sipas tij, do të pasojë konfiskimi, asgjësimi i tyre si dhe, në raste të veçanta (recidive, autoritetit, në përputhje me kompetencat e veta ligjore, agjencia do të anulohet lejet për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit me ushqim. Ai shtoi se ata si institucion janë për përkrahjen e bizneseve, por në rend të parë e kanë jetën e qytetarëve. "Jemi për përkrahjen e biznesit dhe për mbështetjen e tyre dhe do t'u japim

këshilla profesionale në aspektin e procedurave për prodhimin, përpunimin, tregtimin e produkteve ushqimore që na takojnë neve si autoritet kompetent, por asnjëherë nuk do ta lejojmë asnjë biznes që në mënyrë të vetëdijshme të veprojë në kundërshtim me ligjin dhe të rrezikojë shëndetin publik të qytetarëve", ka cekur kryeshefi ekzekutiv i AVUK-ut, Valdet Gjinovci, duke shprehur gatishmërinë e plotë për të bashkëpunuar me të gjitha institucionet e Kosovës, për të realizuar objektivat dhe përgjegjësitë me qëllim mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve të Kosovës. "Detyrë dhe përgjegjësi e AVUK-

ut është mbrojtja e shëndetit të qytetarëve të Kosovës. Të gjithë operatorët e biznesit që veprojnë në territorin e Republikës së Kosovës, obligohen të lajmërojnë autoritetin kompetent për produktet me afat të skaduar ose të pasigurta për konsum, në të kundërtën, do të përballën me sanksione sipas legjislacionit në fuqi".

Mungesë e inspektorëve

Sipas Gjinovci, numri i inspektorëve që ka tani për tani AVUK, është i vogël, por ai ka bërë kërkesë për rritje të stafit. "Kemi një numër të kufizuar të inspektorëve në nivel vendi, të cilët shpesh detyrohemi t'i angazhojmë edhe në detyrat e tjera shtesë për nevojat e agjencisë. Me marrjen e detyrës e kam bërë një riorganizim të stafit brenda sektorëve të cilët edhe kanë lëvizur dhe kanë bërë koordinimin e aktiviteteve të punës. Në

realizimin e këtyre detyrave, përmes personelit nga sektori i inspektoratit janë angazhuar edhe personeli i agjencisë nga sektorët e tjerë. Edhe pse të ndarë në grupe inspektuese, punët janë koordinuar nga qendra, për të vepruar si një ekip i përbashkët. Sipas tij, me Ligjin e Ushqimit, inspektoratet përkatëse komunale, së shpejti do të bashkëngjiten Agjencisë së Ushqimit, që do të funksionojë si një trupë e përbashkët. "Nuk mund të spekulohet se a hyn mish i kontrabanduar. Gjatë këtyre ditëve kur kemi realizuar inspektime kemi hasur në mish me afat të skaduar. I gjithë ky mish ka hyrë nëpërmes metodave të rregullta doganore, me përjashtim të një rasti ku është dyshuar në ndryshimin e origjinës së atij malli dhe me këtë rast është duke u marrë policia e krimeve ekonomike", tha ai.

MISHI VJEN MË SË SHUMTI NGA BRAZILI

Sasia më e madhe e mishit që importohet në Kosovë vjen nga Brazili. Por, sipas Gjinovci, ekziston mundësia që tregtarët, në forma të ndryshme, të ndërhyjnë në dokumentacionin shoqëruar të produkteve. "Mirëpo, ne do të jemi vigjilentë dhe do të verifikojmë dokumentacionin e dërgesave të cilat vijnë nga importi", ka thënë kryeshefi ekzekutiv i AVUK-ut, Valdet Gjinovci. Gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësisë tona si autoritet ne do të punojmë me transparencë të plotë ndaj operatorëve të biznesit me ushqim, po ashtu ndaj medie dhe qytetarëve të vendit. Sipas tij, nuk përjashtohet mundësia e gjetjes së rrugëve të ndryshme nga tregtarët për të futur mish me cilësi të dyshimtë, por premton se ata do të jenë në detyrë 24 orë.

Anëtarësimi në OBT, PROCES I LARGËT



Eko Biznesi

Ndonëse anëtarësimi në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT) është ndër prioritet e Qeverisë, kjo gjë duket se është shumë komplekse. Anëtarësimi në OBT nuk do të ndodh në një afat të shkurtër kohor. Kjo pasi Kosova ende nuk ka aplikuar, përderisa një shteti që nga aplikimi i duhet të paktën 5 vite deri në anëtarësim të plotë.

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Lutfi Zharku, thotë se janë duke punuar në plotësimin e të gjitha kushteve për anëtarësim, në mënyrë që procesi të jetë më i lehtë dhe i shpejtë. Ai e pranon se anëtarësimi është i vështirë për disa arsye.

"Së pari, ky proces kërkon përkushtim të vendit i cili aplikon për të implementuar politikat që janë të lidhura me procesin e anëtarësimit në OBT, dhe së dyti, është kompleksiteti i çështjeve të cilat mund të shtrohen



Procesi i anëtarësimit të Kosovës në Organizatën Botërore të Tregtisë mund të zgjasë me vite, për shkak të procesit të ngadalshëm të reformave dhe zhvillimit ekonomik. MTI-ja thotë se janë duke punuar që kur të aplikojnë për anëtarësi, procesi të kryhet shpejt. Ish-ministri Dugolli thotë se aplikimi është dashur të bëhet më herët



nga anëtarët e OBT-së gjatë procesit të negociimit i cili e komplikon tërë procesin", ka thënë Zharku.

Sipas kreut të MTI-së, një pengesë për anëtarësim janë edhe procedurat të cilat e kushtëzojnë një shtet.

"Ne jemi duke i bërë të gjitha përgatitjet e duhura për të qenë anëtare e OBT-së, e që kanë të bëjnë me ngritjen e infrastrukturës së nevojshme ligjore në fushën e cilësisë, standardizimit, mbrojtjes së pronësisë industriale, mbrojtjes së investimeve, respektimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, liberalizimin e tregut, si dhe çështje të tjera", ka thënë Zharku. Bujar Dugolli, deputet i Parlamentit të Kosovës dhe ish-ministër i Tregtisë e Industrisë, ka deklaruar se për anëtarësim në OBT, terreni ishte përgatitur qysh në vitin 2007. "Ne kemi pasur përkrahjen edhe të Komisionit Evropian dhe kemi marrë premtime nga përfaqësuesit e OBT-së se mund të aplikojmë edhe si territor unik doganor", ka thënë Dugolli. Sipas tij, kjo është diskutuar në mes të Qeverisë së

Kosovës, miqve ndërkombëtarë si dhe këshilltarëve nga USAID-i, dhe se janë marrë rekomandimet që për anëtarësim në këtë organizatë të aplikohet pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Ish-ministri Dugolli kërkon nga qeveria aktuale që të shfrytëzohet mungesa e Rusisë dhe Serbisë në këtë organizatë. "Këto dy vende që mund ta pengojnë Kosovën pas aplikimit, ende nuk janë anëtare të kësaj organizate. Të dyja kanë aplikuar, por ende nuk janë vende anëtare", ka shtuar Dugolli.

Ndërkaq, sekretari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rrukiqi, thotë se duhen bërë përgatitje të mëdha në mënyrë që pastaj të filloj procesi për anëtarësimi në OBT edhe pse është procesi goxha i vështirë.

"Realisht procesi duhet të fillojë pasi që të bëhen një numër i madh i përgatitjeve. Duhet të jemi territor unik doganor si dhe duhet të plotësohet 70 deri në 80 ligje", tha Rrukiqi, duke shtuar se nuk duhet harruar se

Organizatën Botërore të Tregtisë e përbëjnë 153 shtete anëtare, që paraqesin afër 97 për qind të tregtisë botërore. Aplikimi i çdo vendi për anëtarësim pasohet me formimin e grupit punues për shqyrtimin e aplikacionit. Grupi punues, në parim, përbëhet nga shtetet kryesore në OBT-së si dhe shtetet që drejtpërdrejt kanë marrëdhënie tregtare me vendin aplikues. Por, kjo paraqet sfida për Institucionet e Kosovës të cilat synojnë anëtarësimin e Kosovës, edhe atë për shkak të qëndrimit jo përkrahës të disa shteteve ndaj vendit tonë. Rekomandimi i grupit punues në fund i dërgohet Asamblesë së Përgjithshme, gjeçësisht Konferencës ministrore, e cila miraton anëtarësimin me 2/3 e votave, gjeçësisht me votat e së paku 102 shteteve.

procesi i negociatave për anëtarësim është i gjatë.



Privatizimi i KEK-ut nuk sjell humbje të VENDEVE TË PUNËS

Eko Biznesi

Duke pritur që sivjet të privatizohet divizioni i shpërndarjes dhe ai i furnizimit në KEK, kryeministri Hashim Thaçi ka siguruar punëtorët se nuk do të ketë humbje të vendeve të punës. Ai ka thënë se qeveria i ka parasysh të gjitha.

Kryeministri Hashim Thaçi dhe ambasadori amerikan Kristofer Dell kanë shprehur vendosmërinë e privatizimit të shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë në Korporatën Energjetike të Kosovës.

"Objektivat kyçe të cilat do të arrihen përmes këtij privatizimi janë ngritja e sigurisë përmes përmirësimit të inkasimit dhe eliminimit të humbjeve, eliminimin e subvencioneve në sektorin e energjisë nga buxheti i Kosovës dhe nga donatorët, në mënyrë që të fokusohemi në prioritetet tjetra të rëndësishme sociale", ka deklaruar Thaçi.

Këtij procesi, mbështetje të fuqishme i ka dhënë edhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Kristofer Dell. "Procesi i transferimit të distribucionit dhe furnizimit në duar me përvojë të sektorit privat paraqet një hap monumental drejt pozicionimit të Kosovës për rritje ekonomike", ka deklaruar Dell.

Lidhur me rritjen e pakënaqësive sociale, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq, tha se, me rastin e privatizimit të divizioneve të KEK-ut, duhet të zgjidhet mënyra më e mirë për punëtorët. "Ne e kuptojmë se disa veprime lidhur me punëtorët e KEK-ut, apo punëtorët e tjerë, janë të pamangshme, por gjithsesi ju lus që të keni



konideratë, që çdo veprim radikal do të mund të krijonte probleme edhe më të mëdha për ne", deklaroi Rashiq.

Edhe ministri i Ekonomisë dhe Financave, Ahmet Shala, pranoi se një çështje tjetër që do të trajtohet me prioritet është gjetja e zgjidhjes për punëtorët, të cilët do të dalin nga puna me rastin e privatizimit. "Jemi tepër fleksibil sa u përket çështjeve të cilat kanë të bëjnë me temat e

ngritura, në mënyrë që cilësia mos të dëmtohet karshi sfidave që na paraqiten, ose karshi çfarëdo elementi që ka të bëjë me transparencën dhe cilësinë", ka shtur ministri Shala.

Ndërsa, Sindikata e Pavarur e "Elektrokosovës" (SPE) ka kundërshtuar privatizimin e KEK-ut. Sherif Fejzullahu, anëtar i kryesisë së Sindikatës, ka kërkuar nga Qeveria dhe Parlamenti të miratojnë ligjin për

privatizimin e Ndërmarrjeve Publike dhe Ligjin e Punës, si parakusht për të filluar privatizimi. "Nëse këto ligje nuk miratohen, atëherë sindikatat do të detyrohen të hyjnë në greva e protesta për të mbrojtur pozicionet e tyre", ka thënë Fejzullahu.

Ndërsa, sipas ekspertëve të energjisë, rrjeti dhe furnizimi nuk duhet të privatizohen së bashku, pasi një gjë e tillë do të binte në kundërshtim me rregullat e tregut të lirë dhe

me Traktatin e Athinës për Energji, nënshkruar në vitin 1994 dhe të cilin është edhe Kosova.

"Kështu si po bëhet, privatizimi nuk do të duhet të bëhet. Bashkimi i furnizimit me rrjetin është gabim. Rrjeti duhet të mbetet në një formë monopol shtetëror, sikurse që janë KOSTT-i apo bartja. Rrjeti i paprivatizuar siguron tregun e lirë", ka thënë Gazmend Begolli, ekspert i energjetikës.



Pallati në mjegull

Eko Biznesi

Drejtes të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) thonë se ndërmarrja "Pallati i Rinisë, i Kulturës dhe i Sporteve"- Prishtinë, është e evidentuar në regjistrin e AKP-së.

Kjo ndërmarrje është nën administrimin e AKP-së. Zyrtarë të Komunës së Prishtinës thonë se kjo ndërmarrje i takon Komunës së Prishtinës. Derisa të dy palët pretendojnë se kanë të drejtë, ende askush nuk e di se cili do të jetë fati i Pallatit të Rinisë.

Drejtorja e Pallatit të Rinisë nuk është në dijeni nëse i janë pranuar projektet nga ana e Komisionit Evropian për investime në pjesën e djegur të këtij objekti dhe renovimin e tërësishëm të tij.

Në AKP thonë se pallati gjendet ende në listat për privatizim. Rreziku se Pallati i Rinisë mund të privatizohet ende nuk ka kaluar.

Komuna e Prishtinës i ka kërkuar Qeverisë këtë objekt që ta kthejë nën menaxhim, por kjo e fundit ka hezituar të japë sinjale se kujt duhet t'i takojë objekti.

Qeveria e Kosovës, si duket, i ka hapur rrugë privatizimit të kësaj ndërmarrje me ndryshimet që i ka bërë në

”

Komuna e Prishtinës kërkon që Pallati i Rinisë të mbetet nën menaxhimin e saj, kurse Agjencia Kosovare e Privatizimit pretendon se kjo ndërmarrje, ashtu si të gjitha ndërmarrjet e tjera shoqërore, do t'i nënshtrohet procesit të privatizimit. Deri më tani, askush nuk e di qartë se çka do të ndodhë me Pallatin e Rinisë

”

projektligjin për Komunën e Prishtinës, në të cilin e ka dorëzuar në

Kuvendin e Kosovës.

Me ndryshimet që i ka bërë Qeveria, projektligji i Prishtinës shkon në Kuvend pa Pallatin e Rinisë dhe pa grantin shtesë.

Pikerisht për shkak të këtyre paqartësive, ditë më parë, është humbur mundësia që në këtë ndërmarrje të investohen 14 milionë euro nga Komisioni Evropian, mjete këto të cilat KE-ja tani do t'i investojë në Komunën e Mitrovicës.

Zëdhënësi i AKP-së, Ylli Kaloshi, për "Eko Biznes", ka thënë se AKP është e autorizuar që të administrojë me ndërmarrjet në pronësi shoqërore, njësoj si edhe me Pallatin e Rinisë.

Ndërkaq, Komuna e Prishtinës i konsideron të papranueshme ndryshimet në projektligji. Në një prononcim të mëhershëm për njërin nga mediat e shkruara, i pari i Prishtinës, Isa Mustafa, paralajmërimet për mundësitë e ndryshimit në Qeveri të projektligjit për Prishtinë i kishte quajtur absurde dhe jashtë praktikave normale të bërjes së ligjeve.

"Nuk është në praktiken e bërjes së ligjeve që ato njëherë të miratohen e pastaj të shqyrtohen e të ndryshohen", ka theksuar Mustafa.

"Normat dhe procedurat janë të qarta. Ato thonë se projektligjet duhen diskutuar dhe gjatë diskutimit

mund të afrohen edhe propozimet për ndryshime. Pas kësaj bëhet miratimi i ligjit, ashtu edhe siç ka ndodhur me draftin për Prishtinë dhe në vend që drafti të procedohet për Kuvend, ai është kthyer në rishqyrtim, gjë që paraqet dalje totale jashtë normave juridike të bërjes së ligjeve".

Ndërkaq, në Qeveri thonë se është kryer pjesa e punës së tyre. Zëdhënësi i Qeverisë, Memli Krasniqi, ka thënë se qeveria e ka proceduar draftin për në Kuvend. "Gjatë procedimit është dashur të sigurohemi që përmbajtja e draftit të jetë në përputhje me normal ligjore në fuqi dhe në përputhje me kapacitetet buxhetore që ka vendi", ka pohuar Krasniqi. Sipas tij, menaxhimi i ndërmarrjeve nuk mund të ndryshohet me aprovimin e ligjeve të veçanta. "Menaxhimi i ndërmarrjeve apo pallateve është përcaktuar me norma të mëhershme dhe tani ai menaxhim nuk mund të kalojë në një institucion tjetër përmes një ligji, i cili për fokus nuk ka qështjen e rregullimit të kësaj sferë", ka theksuar Krasniqi. Udheheqësit e Komunës së Prishtinës kanë shfaqur bindjen që ndryshimet

që janë bërë në përmbajtjen e projektligjit do të kthehen gjatë shqyrtimit dhe miratimit parlamentar. "Ne nuk

jemi konsultuar dhe as informuar që përmbajtja e projektligjit mund të ndryshojë. Ajo që ka kërkuar Komuna e Prishtinës ka qenë procedimi i projektligjit dhe jo ndryshimi i tij", ka thënë Muhamet Gashi, zëdhënësi i Komunës së Prishtinës, duke folur në emër të kabinetit të kryetarit Mustafa. Ai ka theksuar që nënet e larguara do të kthehen në përmbajtjen e ligjit gjatë kohës së shqyrtimit parlamentar. "Tani drafti është në duart e Kuvendit dhe aty ka mundësi që përmbajtja e ligjit të ndryshohet dhe të plotësohet. Kjo presim të ndodhë edhe me draftin për Prishtinë", ka pohuar Gashi.

Ky i fundit i ka quajtur jo të drejta përpjekjet e Qeverisë së Kosovës për t'ia pamundësuar Komunës së Prishtinës menaxhimin e Pallatit të Rinisë dhe të Sporteve.

"Komuna e Prishtinës ka të drejtë të kërkojë të menaxhojë objektin e Pallatit të Rinisë dhe të Sporteve, pasi që ai është ndërtuar me vetëkontributin e banorëve të Prishtinës dhe me kredi bankare", ka thënë Gashi, teksa ka shtuar që objekti i Pallatit të Rinisë dhe të Sporteve është ndërtuar në formën e ngjashme, siç është ndërtuar pishina "Gërmia", të cilën e menaxhon komuna.

Bizneset kërkojnë falje TË NDËSHKIMEVE

Eko Biznesi

Procesi i fiskalizimit të bizneseve mbetet shumë i kënaqshëm për zyrtarë të Administratës Tatimore të Kosovës, ani pse procesi vazhdon të ketë vonesa. Ata kanë bërë të ditur se mbi 550 biznese të dy kategorive që tash për tash janë të detyruara ti vendosin arkat fiskale, njësit e mëdha dhe ato të mesme. "Deri më tani janë instaluar 1300 pajisje elektronike fiskale", kanë thënë zyrtarë të ATK-së. Në momentin që ka përfunduar afati për vendosjen e arkave, ky institucion ka nisur edhe vendosjen e gjobave për ato kompani që nuk iu kanë bindur vendimit të marrë. "Sipas raporteve, gjerë më tani janë shqiptuar 20 gjoba. Ne ende jemi në fazën e evidentimit dhe informimit të gjithë tatimpaguesve, të cilët janë të obliguar të pajisen me Pajisje Elektronike Fiskale dhe deri më tani jemi duke ndëshkuar vetëm bizneset të cilat kanë refuzuar që të pajisen me PEF", kanë deklaruar zyrtarët e ATK.

E nga ana tjetër, zëdhënësi i Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, Muharrem Shahini, ka thënë se Qeveria e Kosovës ka vendosur që, nëse tatimpaguesi është i gatshëm të paguajë borxhin tatimor të vitit 2008 tërësisht, atëherë ndëshkimet e vendosura si rezultat i tatimit të papaguar do t'i hiqen.

"Ky është vendim i Qeverisë, i cili konsiderohet të jetë pasues i vendimit të mëhershëm Nr. 07/35, të datës 10 shtator 2008, të lëshuar nga Qeveria për të ofruar lehtësim në ndëshkime për tatimpaguesit. Bazuar në atë vendim të mëhershëm, është ofruar mundësia e lehtësimit në ndëshkime vetëm deri më 31 dhjetor 2008. Në mënyrë që të realizohet zbatimi i atij vendimi, tatimpaguesit është dashur që t'i zbatojnë marrëveshjet deri më 12 muaj, nga data e marrëveshjes që nënkupton se pagesa përfundimtare është dashur të bëhet deri më 31 dhjetor 2009", ka thënë Shahini. Sipas tij, duke pasur parasysh, se shumë borxhlinj tatimorë kanë bërë përpjekje të besueshme për t'u përmbytur marrëveshjeve të tyre, por kanë dështuar në pagesa (kanë pasuar vështirësi financiare gjatë 2009) dhe nuk mund ta arrijnë afatin e pagesës deri më 31 dhjetor 2009, është propozuar që t'u jepet edhe një mundësi për pjesën e borxheve që i takojnë periudhës së vitit 2008. Shumë biznese kanë kërkuar falje të ndëshkimeve që sipas tyre do të



ndikonte në vendosjen e menjëherëshme të arkave fiskale, pasi që kjo vonesë ka ndodhur si pasojë e problemeve me financat. ATK-ja ka thënë se bazuar në Ligjin mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat 03/L-071, të gjithë tatimpaguesit kanë të drejtë të parashtrijnë kërkesë për ulje apo falje të ndëshkimeve.

"Kërkesa e tyre merret parasysh nga

Komisioni për ulje apo falje të ndëshkimeve dhe nëse kërkesa është e arsyeshme, ATK-ja me rekomandimin e këtij komisioni mund të marrë vendim për ulje apo falje të ndëshkimit", kanë thënë zyrtarë përgjegjës të ATK-së. Zëdhënësi Shahini ka bërë të ditur se ATK-ja për mbledhjen e borxheve ndërmerr masa të ndryshme, por

gjithmonë ato të cilat janë të parapara me Legjislacionin Tatimorë. "Ndër masat, të cilat ATK do t'i ndërmarr në të ardhmen ndaj tatimpaguesve borxhlinj, janë ofrimi i mundësisë për tatimpaguesit e tillë që të bëjë pagesën e borxhit me këste. Në këto raste, nëse tatimpaguesit hyjnë në marrëveshje për pagesën e borxheve me këste, do t'u stopohet përllogaritja e interesit deri në kohën kur ata të përfundojnë marrëveshjen dhe normal, nëse marrëveshjes së tillë do t'i përmbahen. Gjithashtu, ATK brenda kornizave ligjore ka mandatin që të përdorë edhe masat e sforcuara të mbledhjes së borxheve. Në këto masa radhiten: vendosja e barrës tatimore, konfiskimi i pasurisë së tatimpaguesit, ndalesa për largim nga Kosova, bllokimi i llogarive bankare, tërheqja e mjeteve nga llogaria bankare e tatimpague-

BORXHLINJTË MË TË MËDHENJ TË ATK-SË

Ndërmarrjet Publike
Ndërmarrjet Shoqërore
Organizatat Buxhetore dhe
Bizneset private

sit, ndalimi i ushtrimit të veprimtarisë së tatimpaguesit, si dhe tërheqja e mjeteve nga Thesari në llogari të ATK-së, në rastin e pagesave që do t'u bëhen bizneseve për realizimin e kontratave të ndryshme", është përgjigjur Shahini. Sido që të jetë, shumica e përgjithshme e borxheve që bizneset dhe agjencitë e ndryshme qeveritare apo joqeveritare që i detyrohen ATK-së sillen rreth 268 milionë.



Fiskalizohen 550 BIZNESE

Eko Biznesi

Procesi i fiskalizimit në Kosovë është duke u zhvilluar dhe, deri më tani, vetëm nga grupi i parë i Njësisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj (NJTM) është arritur të fiskalizohen afër 90 për qind të bizneseve dhe rreth 40 për qind të bizneseve të mesme, të cilat çdo ditë po bëjnë kërkesa për fiskalizim.

Ahmet Shala, ministër i Ekonomisë dhe Financave, thotë se procesi i arkave fiskale edhe në vendet në zhvillim ka zgjatur prej 3 deri në 15 vjet.

"ATK-ja ka bërë një punë mjaft të mirë me numrat fiskalë. Këtu është një hallkë e gjitha institucioneve që nuk duhet të presim mrekulli, por është një proces që do të arrijë suksese gjatë vitit 2010", thotë ministri Shala.

Ndërsa, Hava Ademi, nga Administrata Tatimore e Kosovës, thotë se mbi 550 biznese (të NJTM-së dhe ato të mesme) janë fiskalizuar, nga numri i përgjithshëm prej 1300 bizneseve të dy kategorive.

"Kur këtij numri i hiqen edhe bizneset që nuk janë të obliguara të fiskalizohen, sepse kryejnë furnizime të mallrave apo shërbimeve për biznese të tjera, tregon se procesi është në rrugë të mirë. Është

Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Ahmet Shala, tha se ATK-ja ka bërë një punë mjaft të mirë me projektin e numrave fiskalë. Deri më tash, me numra fiskalë janë pajisur rreth 550 biznese

detyrë dhe obligim i çdo tatimpaguesi që të respektojë dhe të zbatojë dispozitat e legjislacionit tatimor të aplikueshëm në Kosovë. ATK-ja ka obligim dhe detyrë që të sigurojë zbatim të njëtrajtshëm të dispozitave ligjore për të gjithë tatimpaguesit", thotë Hava Ademi. Sipas saj, nga bizneset kërkohet të pajisen me arka fiskale dhe është obligim i secilit tatimpagues që të jetë bashkëpunues dhe i ndershëm. Nëse tatimpaguesi nuk do t'i zbatojë dispozitat ligjore, ATK do të ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm dhe të cilat janë të parapara me legjislacionin tatimor relevant në fuqi.



"Në lidhje me këtë, ATK ka angazhuar një pjesë të madhe të stafit operativ në mbikëqyrjen e procesit të fiskalizimit në Republikën e Kosovës", thotë Ademi.

Ndërsa profesori i ekonomisë Nagip Skenderi thotë se vendosja e arkave fiskale është një disiplinë financiare të cilën duhet ta aplikojnë të gjitha bizneset në vendin tonë dhe është një ndihmesë e madhe për të gjitha bizneset qofshin prodhuese apo shërbuese.

Sipas tij, aplikimi i këtyre arkave fiskale që bëhet për herë të parë në Kosovë, është një meritë e vërtetë e ATK-së dhe MEF-it, sepse ligjërisht po vendoset një ndër parakushtet kryesore të disiplinës financiare që ka të bëjë me fushën e tatimeve dhe taksave të tjera fiskale. Ai konsideron se ATK-ja, në bashkëpunim me koordinim me OEK-un dhe AKB-në, do të duhej fillimisht të organizonin trajnime dhe këshillime të bizneseve për përparësitë e kësaj risie në bizneset e tyre dhe se si do të duhej manipuluar me to gjatë aktivitetit biznesor", thotë Skenderi.

Sipas tij, evazion fiskal në Kosovë ka mjaft, që shprehet nëpërmjet bizneseve aktive të pargjistruara, sidomos në pjesën e populluar me pakicën serbe, që nuk dëshiron t'i paguajë kontributet dhe tatimet, shtetit të Kosovës.



e Re

me vetëm **3** euro
tani mund të flisni
brenda javës
60 minuta
me Vala.



ËSHTË E KOSOVËSI

Aktivizimi i pakos bëhet duke telefonuar në nr. **211**
dhe duke zgjedhur nr.7

www.valamobile.com

Eko Biznesi

Pavarësisht bilbordeve që shihen në rrugë, sipas ekspertëve dhe kompanive që merren me marketing, për këtë sektor nuk është vetëdijësimi i duhur. Mosinvestimi i kompanive në biznes i dëmton më shumë kompanitë. Ky është mendimi i përfaqësuesve të kompanive të specializuara të marketingut dhe i ekspertëve të ekonomisë. Drejtori i hulumtimeve në institutin "Rinvest", Alban Zogaj, thotë se bizneset kosovare i japin pak rëndësi marketingut modern. "Ne të gjithë, e sidomos ekonomistët, jemi të vetëdijshëm se marketingu, në kuptimin e plotë të termit, është një prej elementeve kryesore të suksesit të disa prej kompanive të mëdha si botërore ashtu edhe vendore. Kjo është vërtetuar në shumë raste edhe me studime empirike. Por edhe pse në dhjetë vitet e fundit në Kosovë kemi përjetuar një zhvillim të hovshëm të bizneseve në shumë aspekte të afarizmit, prapëseprapë marketingu modern i jepet shumë pak rëndësi", thotë Zogaj.

Nënvlerësimi i marketingut

Ai konsideron se format e promovimit në Kosovë janë zhvilluar në nivel të kënaqshëm, kurse hulumtimi në përgjithësi kërkoi më shumë investim dhe vëmendje, mirëpo këto shikohen fare pak si domosdoshmëri nga biznesi kosovar. "Në Kosovë ka shumë pak kompani, ose pothuajse fare, të cilat para se të zhvillojnë një produkt të ri ose para se të futen në ndonjë treg të ri, kryejnë hulumtimet përkatëse", mendon Zogaj. Fisnik Ismaili, drejtor ekzekutiv i kompanisë "Ogilvy Albania & Kosova", thotë se shumica e kompanive kosovare e nënvlerësojnë marketingun për dy arsye. "E para është se nuk duan të shpenzojnë në diçka që nuk e dinë se

Bizneset investojnë PAK NË MARKETING



Bizneset kosovare investojnë shumë pak në fushën e marketingut. Ekspertët rekomandojnë që kompanitë të ndajnë 10 për qind të buxhetit për marketing. Marketingu është pjesë përbërëse e biznesit, pa të cilën, një produkt apo shërbim nuk mund të plasohet në treg, dhe këtë fakt tani, kompanitë kosovare po e kuptojnë çdo ditë e më shumë



jnë nga kjo. Mirëpo, sipas tij, "viteve të fundit po vërehet një ndryshim pozitiv, sadopak i vogël, dhe ndryshime më të mëdha do të ketë vetëm kur kompanitë të fillojnë ta vlerësojnë cilësinë dhe ta kërkojnë atë nga agjencitë e reklamimit".

Bizneset pa buxhet për marketing

Sipas Ismajlit, pikërisht për arsye se shumica e bizneseve nuk janë të gatshme të ndajnë më shumë buxhet për marketing, po dëmtohet kjo industri, sepse zakonisht agjencitë e marketingut (reklamimit) përzgjidhen në bazë të ofertës më të lirë financiare, e jo cilësisë që e ofrojnë. "Në këtë mënyrë, të gjithë dëmtohen. Për shembull, kompanitë që mudojnë të kursejnë duke prodhuar një reklamë jocilësore në mënyrë që të blejnë sa më shumë sekonda në TV, përfundojnë duke e lëshuar një

reklamë të punuar keq për një kohë më të gjatë, sesa një reklamë më të mirë për një kohë më të shkurtër, duke mos ditur se kjo ka efekt negativ në produktin që po reklamohet", tha ai.

Dëmi nga mungesa e marketingut

I mendimit të njëjtë është edhe Genc Meraku, që udhëheq agjencinë e marketingut "Zero Positive". Dëmi që iu bëhet këtyre kompanive që janë të specializuara në këtë fushë, nga kompanitë që shtrihen se janë të specializuara, sipas tij, është shumë i madh. "Ne kemi investuar pa masë në ngritjen e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve të marketingut, por fatkeqësisht në Kosovë dalin kompani që thirren se janë të gatshme të ofrojnë shërbime të marketingut dhe me njoftësi apo në forma të ndryshme jokonkurrese marrin punë nga institucionet e ndryshme. Kjo neve na dëmton pa masë", thotë Meraku. "Marketingu është pjesë përbërëse e biznesit, pa të cilën, një produkt apo shërbim nuk mund të plasohet në treg dhe këtë fakt tani, kompanitë kosovare po e kuptojnë çdo ditë e më shumë. Por, fatkeqësisht ata janë duke i zgjedhur kompanitë joprofesionale duke u bazuar në çmim të ulët apo në afërsi të kompanive, e që në anën tjetër kjo po u kushton shumë bizneseve tona në reklamimin e produkteve të tyre. Me kësaj marketingu ata janë duke bërë kundër-propagandë për produktin e tyre", thekson Meraku.

Ndikimi në perceptimin e qytetarëve

Ndërkohë, një ndër kompanitë kosovare që më së shumti ka investuar në reklamimin e produkteve të saja është kompania IPKO. "IPKO-ja është njëra nga kompanitë që zhvillon aktivitete të kompletuara të marketingut dhe të promovimit duke qenë e vetëdijshme se informimi dhe perceptimi i qytetarëve drejtpërdrejt ndikojnë në rritjen e shitjes dhe të imazhit të biznesit", thotë Alban Kastrati, zëdhënës i kompanisë IPKO. Sipas tij, në tregun kosovar, kompania IPKO është shndërruar në një promotor të aktiviteteve të marketingut dhe të promovimit, ndryshe nga ato që janë zhvilluar deri më tani duke zbatuar qasjen e komunikimit të integruar të marketingut. "Ne kemi Departamentin e Marketingut si dhe angazhojmë kompani me renome botërore në konceptimin dhe prodhimin e fushatave të marketingut", thotë ai. Për këtë kompani nuk është edhe aq e rëndësishme çmimi i shërbimeve të marketingut, sa është ideja. "Ne gjithashtu bëjmë edhe shumë hulumtime për tregut, të cilat na orientojnë në aktivitetet tona, pasi që jemi një kompani tërësisht e orientuar nga plotësimi i kërkesave të konsumatorëve", ka përfunduar Kastrati. Praktikant botërore tregojnë që një përqindje e caktuar e qarkullimit vjetor, në raste të caktuara deri në 10 për qind, duhet të ndahet për marketing.

Eko Biznesi

Drejtori i Agjencisë për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme, Naser Graičevci, ka potencuar për "Eko Biznes" se zyrtarisht janë 1,100 biznese të shuara. "Problemi qëndron me 20 mijë biznese të tjera, për të cilat nuk dihet nëse kanë falimentuar apo veprimtarinë e tyre e zhvillojnë në mënyrë joligjore", ka theksuar ai. Sipas tij, janë 100 mijë biznese të regjistruara aktualisht në regjistrin e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve "Vitin e kaluar, Administrata Tatimore ka formuluar një listë prej 20 mijë bizneseve, të cilat nuk janë funksionale, përderisa Administrata Tatimore e Kosovës në raportin se vetëm 43 mijë biznese janë tatimpaguese. Kjo nënkupton se kemi një numër të madh të informalitetit gjymëzyrtar", ka deklaruar Graičevci. Ata që kontribuojnë në të hyrat e ATK-së, janë vetëm 43 mijë biznese që konsiderohen tatimpaguese të rregullt nga 100 mijë sa janë të regjistruara në Agjencinë për regjistrim të biz-

Shuhen 1100 biznese

neseve në MTI.

Zyrtarë të Administratës Tatimore të Kosovës thonë se, pajisja me numër fiskal do të qartësojë se cilat janë biznese funksionale dhe cilat janë biznese fiktive. Ndërkaq, zyrtarë të Administratës Tatimore të Kosovës arsyetojnë se numri i bizneseve të regjistruara është dyfishuar apo rirregjistruar pas marrjes së kompetencave nga UNMIK-u. Shefi Shërbimit dhe Edukimit të tatimpaguesve në ATK, Ruzhdi Zenelaj, thotë se numri i bizneseve në MTI është dyfishuar.

"Duke pasur parasysh se ka pasur dyfishim të numrit të bizneseve në rastin e rirregjistrimit të bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, pas marrjes së kompetencave nga UNMIK-u". Sipas tij, shumë biznese nuk punojnë dhe janë mbyllur, kurse, në anën tjetër, asnjëherë nuk kanë bërë kërkesë për reregjistrimin e tyre. Pajisja me numër fiskal të bizneseve,

sipas Zenelajt, do t'i sqarojë të gjitha paqartësitë se sa biznese funksionojnë realisht dhe sa janë fiktive. "Bazuar në këto që u thanë më lartë, për të pasur numrin më të saktë të tatimpaguesve në Republikën e Kosovës, Administrata Tatimore tani i pajis të gjithë tatimpaguesit me nga një Numër Fiskal dhe ne tani nga MTI, vetëm marrim informata në lidhje me bizneset e reja të regjistruara, sepse përndryshe ne i identifikojmë me Numër Fiskal", ka thënë Zenelaj. Kurse, eksperti i ekonomisë Berat Rrukiqi thotë se, sipas shënimeve të ATK-së, obligimet e tyre i kanë paguar mbi 40 mijë biznese. Sipas tij, ajo që duhet të adresohet, është se kemi 100 mijë biznese të regjistruara dhe kemi 40 mijë biznese që paguajnë tatimet sipas ATK-së. "Ne vetëlavdërohem kur themi se biznese regjistrohet për një ditë, por pjesa e pasregjistrimit duhet të jetë më e kontrolluar, pajisja me numra

fiskalë do të na japë një pasqyrë më të saktë të bizneseve funksionale, mirëpo përsëri niveli i informalitetit dhe evazionit fiskal edhe më tutje është i lartë, sepse është një diskrepancë e madhe mes bizneseve që paguajnë tatim dhe atyre që nuk paguajnë", ka potencuar ai, duke shtuar se, në Kosovë, ka shumë biznese fiktive, apo nuk funksionojnë fare, dhe tani procesi i pajisjes së këtyre bizneseve me numra fiskalë ka ndikuar që një pjesë e tyre të tërhiqen në mënyrë vullnetare. "Këto biznese janë biznese që nuk kanë pasur ndonjë afizhim të madh dhe në kushtet e ashpërsimit të konkurrencës nuk e kanë gjetur veten, kjo është arsyeja pse kanë vendosur të tërhiqen dhe të vetëmbijtelin", ka potencuar ai. Rrukiqi është shprehur se një numër i bizneseve të mbyllura këtë vit ndoshta do të jetë edhe më i lartë dhe kjo nuk lidhet me krizën, por me

mungesën e gjetjes së përkrahjes financiare. "Sepse si biznese të reja dhe të pa traditë, nuk kanë mundur të sigurojnë mbështetje financiare për rritjen e investimeve e cila do tua mundësonte një qëndrëse më afatgjatë në treg", tha Rrukiqi. Ndryshe, shumica e bizneseve të regjistruara janë mikro-ndërmarrje, edhe numri më i madh i të punësuarve është në këtë kategori. Sipas numrit të punëtorëve të regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve, në këtë kategori janë 161,319 punëtorë. Në ndërmarrje të vogla janë të punësuar 22,865 punëtorë dhe në ndërmarrje të mesme janë të punësuar 21,718 punëtorë. Ndërkaq, ndërmarrjet e mëdha me mbi 250 punëtorë, që janë vetëm 58 sosh në tërë Kosovën, punësojnë 55,658 punëtorë, duke llogaritur edhe të punësuarit në ndërmarrjet shoqërore dhe publike.

Safet Gërxhalliu, kryetar i OEK-ut



15 viti, është paraqitur tendenca që

Eko Biznesi

Me 52 vota pro dhe vetëm 1 votë kundër, Safet Gërxhalliu është zgjedhur të premtën kryetar i ri i Odës Ekonomike të Kosovës.

Odës Ekonomike i imponohet një fushatë klasike politiko-zgjedhore përpara mbajtjes së këtij kuvendi. Por, në Odë e refuzuar këte qasje.

KANDIDATURA E GËRXHALIUT, FUQIPLOTE

Komisioni zgjedhor ka konstatuar të premtën se kandidatura e Safet Gërxhalliut për kryetar të Odës Ekonomike është e vetmja e cila është fuqiplote për këtë Kuvend zgjedhor, respektivisht që vetëm ai i plotëson kushtet për tu kandiduar për postin e kryetarit të Odës.

Refuzuar që të ushtrime fushatë politike për postin kryesor në një institucion profesional dhe apolitik.

Oda është parti politike

Me këtë rast, Gërxhalliu theksoi se ishin dhe janë të bindur se Oda Ekonomike nuk është parti politike. "Po ashtu, komuniteti të cilin Oda e përfaqëson nuk zhvillon lufte politike për pushtet. Ky komunitet i përbahet logjikës së bashkimit të forcave për artikulimin e mirëfillt të interesave të tij në shoqëri dhe jo ndarjes së këtyre forcave. Kjo ishte arsyeja kryesore që une dhe ekipi im në krye të Odës refuzuam që të implikohemi në këtë fushatë, kur ajo u hap tre muaj më parë", ka potencuar ai. Gërxhalliu theksoi se ishte i bindur se me sukses do të mund të ballafaqeshim me imponuesit e modelit politik për zgjedhjet në Odë.

"Përbaheshim nga lufta politike, sepse e dinim se nëse do të pranionim ushtrimin e fushatës politike për një post apolitik dhe profesional, pra ekonomik e biznesor, atëherë do të krijonim hapësirë për ndarjet në komunitetin e biznesit. Pra, nuk u impikuam në fushatën politiko-zgjedhore që na imponohet jo nga frika nga kundërshtari, por nga bindja se misioni i Odës Ekonomike është të bashkojë e jo ta ndajë komunitetin e biznesit", tha ai.

Kuvendi i Odës, të premtën, në mënyrë transparente është deklaruar që të përkrahë opsionin tonë, tha Gërxhalliu. "Kjo është përgjigja më e mirë e mundshme ndaj tendencës që procesi i zgjedhjes së kryetarit të Odës të shndërrohet në garë politike. Kuvendi ka refuzuar sot në mënyrë kategorike tendencën për politizimin e Odës Ekonomike dhe shndërrimin e saj në organ politik.



Shtrenjtohet ari, bie shitja



Çmimi i arit ka shënuar ngritje edhe në tregun e Kosovës. Artarët thonë se si pasojë e shtrenjtimit, shitja e këtij metali të çmueshëm ka rënë



Eko Biznesi

Çmimi i arit në muajt e fundit në Kosovë ka shënuar rritje të vazhdueshme. Sipas tregtarëve, një gram i metali të çmueshëm kushtonte 18 euro, kurse tash një gram arit kushton 23 euro, varësisht nga përpunimi i tij.

Ndërkaq, zyrtarë të Doganave të Kosovës thonë se kanë pasur vështirësi në zhdoganimin e tij, për shkak të mungesës së vullnetit të tregtarëve për të deklaruar sasi të importuara në kufi. Zedhënasi i Doganave të Kosovës, Adriatik Stavileci, tha për gazetën "Eko Biznesi" se edhe pse në mungesë të vullnetit nga ana e tregtarëve, dogana ushtron kontroll nëpër dyqane, në mënyrë që të mbajnë nën kontroll tregtimin e tij, në bashkëpunim me Administratën Tatimore në Kosovë.

"Ne kemi gjetur një zgjidhje përmes kontrollit nëpër dyqane të cilat merrin me këtë veprimtari. Vetëm gjatë vitit të kaluar, ne kemi konfiskuar afro 60 kilogramë ari nëpër argjendaritë e ndryshme të Kosovës, me vlerë mbi 500 mijë euro, ndërsa gjatë këtij viti kemi pasur sasi të ultë të deklarimeve në kufi", tha Stavileci. Kryetari i Shoqatës së Artarëve dhe Argjendarëve të Kosovës, Enver Pakashitica, tha se si shoqatë nuk kanë ndikim në përcaktimin e çmimit të arit në Kosovë, sepse ajo vjen si pasojë e shtrenjtimit në vendet e mëdha prodhuese të arit në botë. "Shtrenjtimi i arit në Kosovë ka ardhur si rezultat i shtrenjtimit të arit në berzën ndërkombëtare, por ky shtrenjtim në Kosovë bëhet me ngadalë. Tani për tani, veprimtaria e artarëve të Kosovës është në një gjendje të palakmueshme, sepse kriza globale ka ndikuar drejtpërdrejt në veprimtarinë tonë, sepse çdo ditë e më shumë, kjo krizë e shfaqur po ndikon në mbylljen e subjekteve afariste të arpunuesve. Duke pasur

parasysht krizën ekonomike në përgjithësi, e cila ka kapluar botën dhe Kosovën, atëherë dihet se veprimtaria jonë është e kategorisë së njerëzve që kanë një luks, e të cilët janë të paktë në Kosovë dhe imagjinoni se sa mund ta ketë prekur kriza veprimtarinë e arpunuesve në vendin tonë". Sipas kryetarit Pakashitica, problemi kryesor i shoqatës së artarëve ka qenë me Doganat e Kosovës për ushtrimin e veprimtarisë, në mungesë të një ligji të mirëfilltë për veprimtarinë e argjendarive. Ai thotë se ligji ekzistues ka qenë shumë i mangët për veprimtarinë e tyre, sepse ka qenë një ligj i cili ka rënë ndesh me vetveten për importin e arit dhe për përcaktimin e pastërtisë së arit.

Por ai thekson se në bashkëpunim me institucionet e vendit i kanë nxjerrë disa udhëzime administrative. "Me angazhimin e Shoqatës së Artarëve në bashkëpunim me Odën Ekonomike, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Institutin e Metrologjisë dhe disa institucioneve tjera ia kemi arritur që të nxjerrim tri udhëzime administrative për funksionimin dhe lejimin e ushtrimit sa më efikas të veprimtarisë së artarëve dhe argjendarëve në Kosovë. Fillimi i punës së laboratorit për përcaktimin e pastërtisë dhe cilësisë së arit ka qenë po ashtu suksesi i këtij bashkëpunimi të cekur më lartë. Pakashitica thotë se në këtë drejtim mbetet ende për tu bërë sa i përket sqarimit të veprimtarisë së arpunuesve në raport me institucionet e Kosovës.

Alush Shehu, argjendar, tha se kohëve të fundit si pasojë e ngritjes së çmimit të arit në bursën ndërkombëtare, edhe në Kosovë kanë filluar të ngriten çmimet. "Varësisht nga përpunimi i arit, edhe çmimet ndryshojnë, por mesatarisht, një gram ari, tani për tani, kushton nga 22 deri 24 euro". Ai thotë se blerës ka çdo ditë e më pak, dhe sipas tij, po blihen vetëm ato stoli që janë të domosdoshme dhe ceremoniale me rastin e fejesave dhe martesave. Shehu thotë se gjatë verës presin të kenë si çdoherë punë më shumë, për shkak të ardhjes së mërgimtarëve, të cilët në këtë kohë edhe bëjnë fejesa dhe martesë dhe shpenzojnë më shumë. Sipas tij, fuqia blerëse ka rënë shumë. "Edhe pse kemi kliente, por jo si vitet më përpara, e sidomos këtë vit, këtë vit kanë rënë së tepërmi dhuratat e shtrenjta që bëheshin dikur për Ditën e Shen Valentinit dhe 8 Mars".



Prokurimi po i NGADALËSON DONACIONET

Eko Biznesi



Një nga çështjet që kishte zënë vend në Raportin e Progresit për Kosovën të KE-së ishte përmirësimi i procedurave të prokurimeve publike në Kosovë, për të cilat është thënë se po pengojnë donacionet e zotuar për Kosovën dhe po i dekurajojnë investitorët



Autoritetet kosovare kanë zhvilluar takimin e parë të dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit (PSA), gjatë të cilit sërish është vënë në pah problemi i prokurimeve publike, të cilat sipas zyrtarëve evropianë po i rrezikojnë donacionet e premtuara për Kosovën. Në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian, vitin e kaluar ishin kritikuar institucionet kosovare për mënyrën e realizimit të prokurimeve publike, të cilat janë objekt i akuzave për korruption me fondet publike. Sipas KE-së, përmirësimi i prokurimeve publike ndikon edhe në dekurajimin e investimeve të huaja. Takimi i dialogut të PSA u përqendrua në fushat kryesore të reformave dhe autoritetet kosovare janë pajtuan në një varg të veprimeve konkrete. Thëks i veçantë i është kushtuar sundimit të ligjit, luftës kundër korruptionit dhe reformimit të administratës publike.

Ministria e Integritimit dhe Progresit të Komisionit Evropian

Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës dhe ata të Bashkimit Evropian kanë diskutuar edhe për progresin e arritur në zbatimin e agjendës evropiane për Kosovën dhe prioritetet për të ardhmen e afërt. Konkluzionet e këtij takimi është thënë se do të jenë kontribut i drejtpërdrejtë në raportin e progresit të Komisionit Evropian në nëntor. Drejtori për Ballkanin Perëndimor në Komisionin Evropian, Pierre Mirel, theksoi se emerimi i ministrit të Integritimit dhe Progresit të Komisionit Evropian ishte një hap i rëndësishëm për ta nxitur agjendën e reformave për Kosovën, duke shprehur se kjo figurë e nivelit të lartë mund të përmirësojë koordinimin e brendshëm të Kosovës rreth nevojës për reforma për ta arritur këtë perspektivë evropiane.

Diplomati evropian nga Franca, Mirel, tha se e pranojnë që Kosova ka bërë progres në miratimin e legjislacionit, por po ashtu theksoi

nevojën për të bërë më shumë, jo vetëm për të krijuar korvizën e duhur legjislative, por edhe për ta zbatuar atë.

"Kosova duhet të arrijë reforma në mënyrë konkrete, duke u marrë me fushat kyçe sikurse që janë reforma gjyqësore, ngritja e luftës kundër korruptionit dhe reformimi i administratës publike. Shpresoj shumë se Kosova mund të përparojë reformat dhe ne do ta njohim këtë në raportin e progresit këtë vjeshtë", tha ai.

Mirel shtoi se progresi konkret i Kosovës do t'ia mundësojë BE-së t'i çojë përpara propozimet që i ka bërë vitin e kaluar, në veçanti fillimin e dialogut për liberalizimin e vizave. Komisioni Evropian është zotuar sërish se do të vazhdojë përkrahjen për Kosovën nëpërmes programit IPA, i cili tani po fokusohet në fushat ku Kosova duhet të bëjë progres për të arritur perspektivën e saj evropiane, qoftë në kriteret politike, qoftë në ato ekonomike, apo për të plotësuar standardet evropiane.

Gjatë kohës sa qëndroi në Kosovë, delegacioni i Komisionit Evropian ka zhvilluar negociatë me autoritetet kosovare edhe për avancimin e bisedimeve për marrëveshjen e tregtisë së lirë Kosovë-BE.

Raporti i progresit me 85 sfida

Gjatë qëndrimit në Kosovë të delegacionit evropian, ata kanë zhvilluar bisedime edhe me deputetët e Kuvendit të Kosovës nga Komisioni për Integritim Evropian, me të cilin kanë biseduar lidhur me punën e komisionit për harmonizimin e ligjeve të Kosovës me legjislacionin evropian, për sfidat të cilat duhet plotësuar Kosova në rrugën drejt integritimit evropian dhe për procesin e liberalizimit të vizave.

Kryetarja e Komisionit, Zylfije Hundozi, tha se komisioni ka identifikuar 85 sfida që burojnë nga Raporti i Progresit për Kosovën i Komisionit Evropian (e që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, prokurimin, korruptionin), 35 prej të cilave tani janë përmbytur nga Qeveria.

Hundozi ka përmendur faktin që në shtator të vitit 2009 Qeveria e ka marrë për ta ndryshuar Ligjin për Prokurimin Publik, të cilin ende nuk e ka sjellë në Kuvend për miratim. Ajo ka theksuar vullnetin që ekziston në Kosovë për ta luftuar korruptionin, duke pohuar se megjithëkëtë ende nuk janë arritur rezultate të kënaqshme në këtë plan.

Derisa vendet e tjera zhvilluan procesin e stabilizimit-asociimit, Kosova në mungesë të njohjeve edhe nga 5 vende të BE-së po zhvillon negociatat me Brukselin në kuadër të Dialogut të PSA-së. Dialogu i PSA-së është korniza në kuadër të së cilës Komisioni Evropian dhe administrata e Kosovës rregullisht diskutojnë çështjet teknike dhe ato të politikave në lidhje me agjendën evropiane.

Dialogu i PSA-së monitoron dhe përcjell arrijtjen e Kosovës në reforma (në veçanti në lidhje me prioritetet e definuara në Partneritetin Evropian), dhe shpalos se si BE-ja mund ta përkrahë këtë proces.

Progresi i Kosovës në procesin e integritimit evropian varet nga plotësimi i konkluzioneve nga mbledhjet sektoriale dhe plenare të Dialogut të PSA-së. Sapo të finalizohen, konkluzionet nga mbledhjet sektoriale dhe plenare publikohen në faqen e Zyrës ndërlidhëse të KE-së.

Rreth 1 milion euro nga akciza E KAFES NË ARKËN E SHTETIT

Eko Biznesi

Gjatë një viti, në Kosovë futen mesatarisht 700 ton kafe e pjekur dhe 1700 ton kafe e papjekur, ndërkohë që Dogana ka mbledhur mbi 400 mijë euro vetëm nga kafa e pjekur, 520 mijë euro vetëm nga taksa e akcizës. Këto janë të dhëna zyrtare nga Shërbimi Doganor i Kosovës, ndërkohë që jozyrtarisht mësohet se sasi shumë më e madhe e kafes kontrabandohet nga rrugët ilegale të kufirit Kosovë-Mali i Zi.

Deri tash akciza ka qenë 0,30/kg të kafes së gjelbër (e papjekur) dhe 0,60/kg të kafes së pjekur. Zyrtarët e Doganave të Kosovës nuk besojnë se do të ketë rritje të kontrabandës për në vende të tjera.

"Nuk besojmë se do të ketë rritje të kontrabandës së kafes, pasi që edhe një pjesë e vendeve të rajonit nuk kanë akcizë në kafe", ka thënë për "Ekobiznesin", zëdhënësi i Doganave të Kosovës, Adriatik Stavileci.

Tregëtarët bëjnë të ditur se deri tash nuk kanë vërejtur ndonjë ndryshim në



Deri tash, akciza ka qenë 0,30/kg të kafes së gjelbër (e papjekur) dhe 0,60/kg të kafes së pjekur. Zyrtarët e Doganave të Kosovës nuk besojnë se do të ketë rritje të kontrabandës për në vende të tjera



çmim nga importuesit e kafes.

"Edhe pse ka ndryshim të tatimit, në çmim nuk ka lëvizje", ka thënë Albert Bunjaku, pronar i një dyqani në lagjen "Dardania" në Prishtinë.

Nga ana tjetër, burime të gazetës brenda doganave bëjnë të ditur se kafa kontrabandohet edhe me tej.

"Jemi duke ndërmarrë aksion në parandalimin e kontrabandës, që më së shumti po bëhet nga malet në afërsi të Pejës", ka bërë të ditur burimi



i gazetës. Por kafeja që futet në Kosovë shumë pak mbetet këtu, pjesa më e madhe shkon në Shqipëri.

Drejtori Gjeneral i Doganave të Kosovës, Naim Huruglica, ka bërë të ditur për media ditë më parë. Sipas tij, megjithatë, oficerët e Doganës janë në gatishmëri të plotë në 24 orë për ta luftuar dhe për ta ndaluar kontrabandën që dëmton arkën e shtetit.

Zyrtarët doganorë kanë thënë se pas fillimit të punës së EULEX-it në Veri të Kosovës situata është më e mirë, mirëpo ai shpreson se shumë shpejt gjendja aty do të normalizohet krejtësisht. Megjithatë, nga vetë Dogana konfirmohet se kontrabanda e kafes për në vende të tjera përmes Kosovës është duke u zhvilluar edhe më tej. Sipas të dhënave zyrtare të drejtorisë së Doganave të Kosovës, vitin e kalu-

ar, në Kosovë është futur një sasi e konsiderueshme e kafes legalisht duke u zhdoganuar nëpër pikat kufitare.

Burimet bëjnë të ditur se më shumë se 15 për qind e vlerës së përgjithshme të importit të kafes hyn ilegalisht, pjesë e vogël mbetet në vende, ndërkafq pjesa më e madhe sërish kalon kufirin dhe përfundon në tregun Shqiptar.



**KOMPANIA
NDËRKOMBËTARE
E TRANSPORTIT
TË MALLRAVE**

Kush jemi ne?

Railtrans L.L.C. është themeluar nga Z. Besir Çmega, njeri me motive të larta profesionale në organizimin e transportit të mallrave dhe biznesit logjistik, duke ofruar shumëllojshmëri të transportit ndërkombëtar dhe zgjidhje efikase logjistike. Me zotërim të eksperiencës së kombinuar nga puna 5 vjeçare e tij në Hekurudhat e Kosovës Sh.A., ishte i aftë të merr hapa të sigurt për të bërë investim të duhur dhe sot, Railtrans L.L.C. në tregun Kosovor është lider i transportit të mallrave dhe shërbimeve logjistike për transport hekurudhorë dhe transport të kombinuar

Shërbimet
Forma të ndryshme
Transportuese

- Shërbimet e transportit hekurudhorë
- Shërbimet e transportit detar
- Shërbimet e transportit rrugor
- Shërbimet e transportit ajror
- Shërbimet e transportit grupazh (çdo javë) nga Evropa

Shërbimet tjera
Sigurimet Transportuese
Zhdoganimi i Mallrave

Transporti bëhet nga/deri tek Porti
Selanikut Durrësit Barit

Dardania BL 9, LB4 p.n. 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 (0) 38 551 021, Fax: +381 (0) 38 551 470
Mob: +377 (0) 44 333 231, +377 (0) 44 329 881
E-mail: info@railtrans.biz, besir.cmega@railtrans.biz

FAMILJA E PASTËRTISË





Kujtim Kërveshi



Ofrimi i shërbimeve të arbitrazhit në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës (OEK) është një nga objektivat e organizatës sonë. Arbitrazhi në Kosovë nuk ka një histori të gjatë, siç mund të dëshmohet nga vende të tjera më të avancuara



ZHVILLIMI I ARBITRAZHIT NË ODËN EKONOMIKE TË KOSOVËS

Ofrimi i shërbimeve të arbitrazhit në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës (OEK) është një nga objektivat e organizatës sonë. Arbitrazhi në Kosovë nuk ka një histori të gjatë, siç mund të dëshmohet nga vende të tjera më të avancuara. Megjithatë, edhe biznesi kosovar ka pasur mundësinë të përdorë këtë metodë alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve që nga periudha e ish-Jugosllavisë. Fillimisht, në Kosovë, arbitrazhi është aplikuar vetëm për konteste të palëve vendore, ndër- sa, në rastet kur njëra nga palët apo të dy palët kanë qenë të huaja, një mosmarrëveshje e tillë është dashur të trajtohet në Beograd. Kjo ka ndodhur për të gjitha njësitë federative të ish-Jugosllavisë meqë arbitrazhi me element të huaj ishte i centralizuar vetëm në Beograd.

Pas përfundimit të luftës në Kosovë dhe zhvillimeve të para të ekonomisë së tregut të lirë, është shfaqur nevoja e gjetjes dhe zbatimit të praktikave më të mira të trajtimit të mosmarrëveshjeve që lindin në marrëdhëniet tregtare. Si pasojë, OEK kishte ofruar keto shërbime pas luftës menjëherë pas ri-organizimit të OEK. Me miratimin e Ligjit për Odën Ekonomike, është përcaktuar themelimi i një tribunali të arbitrazhit në kuadër të organizatës sonë. Një tribunal i tillë ka funksionuar deri më tani duke u bazuar në një infrastrukturë të brendshme të miratuar menjëherë pa përfundimit të luftës. Për më shumë se caq, legjislacioni në fuqi në Kosovë siç është Ligji për Arbitrazhin ka avancuar tutje infrastrukturës e përgjithshme të fuqizimit dhe zbatimit të arbitrazhit në Kosovë. Është e domosdoshme që organizata jonë të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme që mundësojnë zbatimin e këtij ligji sa më parë. Është e nevojshme që përveç ofrimit të shërbimit të arbitrazhit, organizata jonë të krijoj një infrastrukturë ligjore të brendshme mbi bazën e praktikave më të mira ndërkombëtare dhe Evropiane. Duke qenë dëshmitar të një numri të madh të lëndëve të pa përfunduara në gjykata që

kalon numrin prej 231.000 lëndë, gjetja e metodave dhe mekanizmave të reja që ofrojnë siguri për investitorët dhe komunitetin e biznesit është e domosdoshme për ne. Ne nuk e shohim ofrimin e shërbimeve të arbitrazhit si zëvendësim të sistemit gjyqësor, përkundrazi, ofrimin e shërbimeve të arbitrazhit e konsiderojmë si mënyrë që plotëson dhe ndihmon sundimin e ligjit dhe trajtimin më të shpejtë të mosmarrëveshjeve që mund të lindin nga marrëdhëniet kontraktuale të bizneseve lokale dhe atyre të huaja. Arbitrazhi për dallim nga institucionet gjyqësore është më i shpejtë, është më i besueshëm dhe është konfidencial gjë që

bën shumicën e bizneseve të drejtohen zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me anë të arbitrazhit. Konfidencialiteti, shpejtësia dhe besueshmëria janë elementet të cilat i duhen çdo biznesi jo vetëm për të zgjidhur një mosmarrëveshje eventuale por që në shumicën e rasteve u mundësojnë palëve që të mbeten partner biznesor përkundër një mosmarrëveshje të trajtuar në arbitrazh. Për më tepër, OEK është e përkushtuar që në një afat sa më të shkurtër të mundshëm, të:

- Përcaktojnë standarde për përzgjedhjen dhe aftësimin e arbitrave;
- Përpiloj rregullat procedurale dhe klauzolat standarde të

- arbitrazhit;
- Miratoj tarifa atraktive;
- Krijoj kapacitetin për të administruar arbitrazhin brenda OEK;
- Informoj shfrytëzuesit e mundshëm për përfitimet nga arbitrazhi.

Është koha që Kosova të zbattojë Ligjin për Arbitrazh dhe t'u mundësojë bizneseve metode efektive dhe efikase për zgjidhjen e kontesteve, OEK do të ofroj mundësinë që bizneset vendore dhe bizneset e huaja (ose ato që kanë marrëdhënie kontraktuale me bizneset vendore) të kenë mundësinë të shfrytëzojnë arbitrazhin bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare.

Në këtë aspekt, OEK vlerëson lartë edhe ndihmën e dhënë nga donator siç është rasti i Programit për Sistemin e Përbërimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Zyrës së USAID-it në Kosovë me të cilin OEK ka nënshkruar edhe një Memorandum të Mirëkuptimit i cili do të lehtësojë themelimin e një tribunali të arbitrazhit në kuadër të OEK. Kjo është një mundësi e mirë që themelimi i tribunali të arbitrazhit në Kosovë të ketë edhe përkrahjen dhe vlerësimin e duhur edhe nga komuniteti i donatorëve, investitor dhe përfaqësuesve e të jashtëm në Kosovë. Kjo ndër të tjerash do të bëjë që edhe bizneset dhe organizatat të huaja të kenë besimin e plotë në kredibilitetin dhe cilësinë e ofrimit të arbitrazhit në kuadër të organizatës sonë të nderuar në përputhje me standardet më të avancuara ndërkombëtare.



"Besa Security" me shtrirje në tërë Kosovën

Eko Biznesi



Kompania e Sigurimit "Besa Security" është njëra ndër kompanitë më të mëdha në Kosovë e cila ofron shërbime cilësore dhe kualitative për klientelen e saj si në aspektin fizik, teknik ashtu edhe në atë elektronik. Për faktin se numëron rreth 900 punëtorë, kjo dëshmon qartë për kontributin e saj në buxhetin e shtetit të Republikës së Kosovës, duke përbushur të gjitha obligimet financiare, pra pagesa e rregullt e të gjitha tatimeve. Për këtë dëshmojnë mirënjohjet, në veçanti nga Administrata Tatimore e Kosovës, por edhe ato në kuadër të tatimpaguesve më të mëdhenj në vend, të cilat i kanë ndarë Oda Ekonomike e Kosovës dhe Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Mirënjohje si tatimpagues i rregullt

Në anën tjetër, Granit Hasani, Drejtor i Përgjithshëm i Kompanisë së Sigurimit "Besa Security" për "Ekobiznes" shprehet i kënaqur që shteti ka vlerësuar kontributin e tyre. Ai ka vlerësuar se këto mirënjohje do të kontribuojnë në rritjen e vetëdijes ndaj obligimeve tatimore edhe të bizneset tjera. "Kjo mirënjohje na bën të mendojmë se shteti është duke menduar për bizneset që veprojnë në Kosovë dhe paguajnë tatim me rregull. Tatimi është obligim dhe duhet të paguhet nga secili biznes, mirëpo në këtë rast shteti ka vendosur që tatimpaguesit më të mëdhenj dhe më të rregullt t'i dallojë nga të tjerët së paku me mirënjohje", shprehet Hasani. Ai ka njoftuar se shuma vjetore që Kompania e Sigurimit "Besa Security" ka paguar në emër të tatimeve për vitin 2009, është mbi 182 mijë euro. "Të gjitha obligimet tatimore i kemi kryer brenda afateve ligjore dhe kështu do të veprojmë gjithmonë, ngase ne jemi të vetëdijshëm se vetëm kështu mund të zhvillohet dhe forcohet shteti. Ne i kemi të punësuar afro 900 punëtorë dhe shpresojmë që ky numër do të rritet akoma deri në fund të vitit, andaj me këtë edhe mundësitë tona për të kontribuar edhe me shumë", është shprehur

Kompania e Sigurimit "Besa Security" është e shtrirë në tërë territorin e Kosovës me shërbimet e veta të cilat i ofron përmes punëtorëve të sigurimit fizik, patrullave vëzhguese dhe intervenuese, duke implementuar edhe sigurimin elektronik. Kjo kompani hyn në ranglistën e tatimpaguesve të mëdhenj në vend dhe, vetëm gjatë vitit 2009, në emër të tatimeve, i ka paguar mbi 182 mijë euro, dhe numëron rreth 900 punëtorë

Hasani.

Sigurimi fizik dhe i ndërtesave

Kompania e Sigurimit "Besa Security" është e shtrirë në tërë territorin e Kosovës me shërbimet e veta të cilat i ofron për mes punëtorëve të sigurimit fizik, patrullave vëzhguese dhe intervenuese, duke implementuar edhe sigurimin elektronik. Ndërkohë, veprimtaritë kryesore të kompanisë janë sigurimi fizik, gjegjësisht sigurimi kundër thyerjes me sistem të alarmimit dhe roje fizike, video-vëzhgimi me video-kamera dhe kamera inteligjente, transferin e parave

dhe gjësedeve me vlerë, duke mos përjashtuar edhe mbrojtjen e PRL. "Në të gjitha angazhimet e deritanishme Besa Security ka arritur suksese të larta dhe inkurajuese, duke u ngritur e para në treg. Gjithashtu vlen për të cekur se Kompania e Sigurimit Besa Security bën sigurimin fizik të objekteve dhe personave, kërkesë e cila për momentin është shumë aktuale në treg", ka thënë Hasani. Sa i përket komponentës elektronike të sigurimit përmes sistemit të alarmimit, Hasani ka pohuar se kjo kompani operon me sis-

tem të alarmit kryesisht në Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Istog dhe, së shpejti, sipas tij, kjo veprimtari pritet të zgjerohet edhe në Gjiat dhe në Mitrovicë. "Kurse me roje fizike, montim dhe vëzhgim të kamerave, transfer të aseteve dhe përcjellje të veturave me GPS/GPRS, po veprojmë në tërë Kosovën", ka njoftuar ai.

Mungesa e ligjit për sigurim fizik

Ndërkaq, mosaprovimi i ligjit për sigurim fizik, Hasani ka thënë se e dëmtton tregun e këtij shërbimi. Ai kërkon që ky ligj të miratohet sa më shpejt që është e mundur, në mënyrë që edhe shteti/qeveria, përkatësisht

Ministria e Punëve të Brendshme t'i kryejnë obligimet ndaj tyre, sikurse ata që po i kryejnë obligimet ndaj tyre. "Edhe pse jemi mjaft të hendikepuar për shkak të vakumit ligjor, në njërin anë, në anën tjetër kemi arritur të ndërtojmë një marrëdhënie të bashkëpunimit të ndërsjellët dhe shumë të besueshme dhe të qëndrueshme, andaj shfrytëzoj rastin të falënderoj Policinë e Kosovës për përkrahjen e tyre pa rezervë për intervenimet e tyre të shpejta në çdo rast të thirrjeve tona", është shprehur Hasani. Sidoqoftë, "Besa Security" me shërbimet e saj operon në tregun e Kosovës që nga vitit 2003, dhe që nga ajo kohë, gama e shërbimeve të saj është shkuar duke u rritur.



SHËRBIME 24 ORË

Besa Security ofron shërbime të sigurimit fizik, teknik dhe elektronik, duke zbatuar shërbimin e sigurimit fizik përmes rojeve dhe patrullave për ruajtjen, mbrojtjen e ndërtesave dhe objekte të llojeve të ndryshme, duke filluar nga institucione shtetërore, ambasada, kompani të mëdha dhe të vogla, supermarkete, zyre të ndryshme etj. Një ndër veprimtaritë kryesore të kompanisë është montimi dhe monitorimi i sistemit të alarmeve: alarm kundër thyerjes, alarm kundër zjarrit, duke bërë mbikëqyrjen e pandërprerë gjatë 24 orëve përmes intervenimit të shpejtë me patrulla intervenuese si dhe me shërbimin teknik të montimit dhe mirëmbajtjes.



Rriten çmimet e patundshmërive

Besiana Xharra

Edhe pse kriza ekonomike në Kosovë është në rritje, biznesi me patundshmëri mbetet akoma më i shtrenjti dhe vlera e saj vetëm sa vjen e shtohet. Rënia e çmimeve të tyre nuk ka ndiku as një vit pas krizës globale ekonomike dhe kështu biznesmenët kosovarë investimin më të mirë e shohin në patundshmëri. Por kjo nuk vlen për tërë Kosovën. Prishtina mbetet vendi që çmimet e tokave, banesave e shtëpive vetëm sa shtohen çdo ditë. Tregtia me patundshmëri në Prishtinë nuk ka të ndalur. Çmimet e tokave vetëm rriten, kurse të banesave e shtëpive, ose qëndrojnë me çmimet e vitit të kaluar, ose rriten, kjo varet edhe prej kompanisë dhe kualitetit që ofron në ndërtim.

750 deri në 2000 euro për metër katror

Çmimi i banesave të ndërtuar prej pasluftës sillen prej 750 deri në 1500 për metër katror, dhe ndonjë herë kemi rast kur një metër katror shitet edhe për 2000 euro, tregon Arianit Gega, pronar i Agjencionit për patundshmëri "Real Way" në Prishtinë, i cili shton se çmimi prej 2000 euro për një metër katror kushton vetëm në qendër të Prishtinës. Kurse Kushtrim Peci, pronar i "Kosova Estate", bën të ditur se prej 900 deri në 1500 për metër katror janë çmimet e banesave më afër qendrës, kurse në periferi sillen prej 700 deri në 1000. Sipas tij, këto çmime janë për ndërtimet e reja të cilat kanë leje ndërtimi, derisa banesat e reja pa leje ndërtimi ofrojnë çmime më të ulta që të stimulojnë blerësin. "Çmimet e banesave me leje ndër-



timet e reja po legalizohen dhe po rrisin vlerën, tregon edhe zedhënasi i komunës Prishtinës, Muhamet Gashi. "Ne jemi duke legalizuar shumë ndërtime banimi të cilat përbushin kushtet teknike dhe urbanistike për banim. Kjo e bën që edhe qytetari ta blejë atë pronë më së siguri, për çka sot, në dallim prej viteve më parë, mund të gjejsh në treg banesa vërtet të mira për të blerë", thotë Gashi.

timet e reja po legalizohen dhe po rrisin vlerën, tregon edhe zedhënasi i komunës Prishtinës, Muhamet Gashi. "Ne jemi duke legalizuar shumë ndërtime banimi të cilat përbushin kushtet teknike dhe urbanistike për banim. Kjo e bën që edhe qytetari ta blejë atë pronë më së siguri, për çka sot, në dallim prej viteve më parë, mund të gjejsh në treg banesa vërtet të mira për të blerë", thotë Gashi.

Legalizimi i ndërtimeve të reja

Derisa Peci tregon se çmimet e banesave të vjetra të cilat më herët kanë qenë më të preferuara për blerësin, sot ato shiten më pak, pasi që tani shumica e ndërtimeve të reja po pajisen me leje ndërtimit, diçka që më herët nuk ka ndodhur. "Interesimi i banesave të vjetra ka rënë, pasi më shumë po preferohen të rejtat ku shumica e tyre tani po kanë leje ndërtimi. Megjithatë kjo nuk ka barë që çmimet e banesave të vjetra të ulen. Ato vazhdojnë të sillen prej 1000-2000 euro për metër katror", tha Peci. Se



sillen prej 750-2000, kurse të atyre pa leje ndërtimi sillen prej 500-700", thotë Peci. Ndërkohë, çmimet e shtëpive, sipas tij, janë prej 700 deri në 800 për metër katror, dhe atë në periferi të qytetit të Prishtinës.

Rritet çmimi i tokave

Ndryshe, në krahasim me çmimet e banesave, në Prishtinë janë çmimet e tokave që po rriten më shumë dhe më shpejt. Pjesa më e shtrenjtë e tokës mbetet të Prishtina e Re, por edhe të Lagjja e Spitalit. Në këto vende, një ari tokë kushton prej 20 mijë euro deri në 50 mijë, por edhe më shumë. Derisa vitin e kaluar, çmimet në këto ane

sillen prej 10 mijë e më lartë, bëjnë të ditur agjencitë e patundshmërive. Ndryshe, pas qytetit të Prishtinës, vjen Prizreni, të ciliit, brenda vetëm një vitit, i është rritur vlefata e patundshmërive. Kjo konsiderohet se po ndodh pasi që Prizreni pritet të jetë vend universitar. Në këtë qytet, metri katror i një banese apo shtëpie sillen prej 600 deri në 1000 euro, varësisht sa larg qëndron prej qendrës, bën të ditur Lavdim Zeneli, pronar i agjencisë për patundshmëri "Vegimi" në Prizren. Sipas tij, çmimet në këtë qytet janë rritur më së shumti vitin e fundit, pasi po flitet se do të bëhet një qytet universitar. Edhe çmimet e tokave në këtë qytet, sipas tij, po shënojnë rritje. "Ato sillen prej 10 mijë deri në 20 mijë për një ari, ku po ashtu varet prej vendit", tha Zeneli. Mirëpo, një situatë e tillë nuk qëndron edhe me qytetet e tjera të

Kosovës.

Mitrovica me çmimet më të lira

Derisa kompanitë e ndërtimit në Prishtinë e Prizren shesin objektet e tyre pa prituri shumë, në Mitrovicë ndodh e kundërta. Kjo ka bërë që çmimet e banesave të zbrisin prej 500 euro për metër katror në 400 e në disa raste edhe në 350. "Ndërtimi është duke ecur shumë dobët. Fuqia blerëse ka rënë, sidomos në dy vitet e fundit. Kjo ka bërë që të ulim çmimet e banesave dhe herë t'i shesim ato edhe pa fitim që, të paktën, të mos mbesin pa shitur", ankohet Fehmi Gojani, pronari i një kompanie ndërtuese në Mitrovicë. Njëjtë si Mitrovica qëndrojnë edhe qyteti i Gjakovës, i Gjilanit dhe i Pejë. Edhe në këto tri qytete metrin katror për një banesë mund ta gjejsh për vetëm 350 euro.

Femrat, të barabarta ME MESHKUJT



Përballë sfidave dhe problemeve të njëjta, femrat dhe meshkujt janë të barabartë në çdo sferë. Sidomos në menaxhim, femrat kanë dëshmuar se dinë të jenë shumë të suksesshme.

Kështu thotë
Sadberë Latifi -

Osa,
bashkëpronare e fabrikës për prodhimin e pajisjeve dhe aparateve për ftohje dhe ngrohje "Osa Termosistemi" në Rahovec



Eko Biznesi

Kur diplomoi për teknologji në vitin 1979, Sadberja ëndërronte të bëhej një teknologe e zonja dhe e suksesshme.

Fillimisht ka punuar në fabrikën për përpunimin e plastikës "18 Nëntori" në Rahovec, rreth katër vjet.

Ajo udhëhiqte laboratorin, ku bëheshin analizat për prodhime të akumulatorëve, të cilët janë eksportuar edhe jashtë vendit.

Pastaj kalon si udhëheqëse e prodhimit në të njëjtën fabrikë, respektivisht në repartin e prodhimit të thasëve, ku lëndë e parë e prodhimit ishte polietileni. "Isha e re dhe kisha shumë vullnet për punë. Puna më pëlqente mjaft dhe u tregova vërtet e suksesshme në të dy punët, edhe si udhëheqëse laboratorit, por edhe si drejtuese e repartit të prodhimit", thotë Sadberë Osa.

Në vitin 2003, ajo me bashkëshortin kanë blerë ndërmarrjen "Osa Termosistemi", ku është



bashkëpronare.

Prej atij viti, kanë filluar të punojnë dhe të prodhojnë, duke shtuar prodhimet nga viti në vit, njëkohësisht edhe gamën e produkteve dhe numrin e të punësuarve.

Ekipi menaxhues përbëhet nga pesë inxhinierë të makinerisë, dy teknologë, një inxhinier i elektronikës dhe dy ekonomistë.

"Numri i personelit të ndërmarrjes arrin në 55 persona. Kemi mbi 200 lloje të prodhimeve. Puna shkoi

mirë, krahasuar me prodhimin në përgjithësi në Kosovë. Çdo vit e rrisim cilësinë dhe numrin e prodhimeve", shprehet ajo, duke mos e fshehur edhe kënaqësinë dhe entuziazmin për këtë.

Fabrika "Osa Termosistemi" në Rahovec, me qarkullim vjetor rreth një milion euro, prodhon kryesisht vitrina ftohëse vertikale, horizontale, kaloriferë për ngrohje, elemente të thata për restorante, dhoma të ftohjeve.

Sadberë Osa tha se prodhimet e tyre, përveç në tregun vendor, i plasojnë edhe jashtë vendit, si në Slloveni, në Kroaci, në Maqedoni, në Shqipëri dhe në Serbi.

"Përveç cilësisë së qëndrueshme, prodhimet tona kanë dizajn bashkëkohor, çmime të pranueshme dhe afate të shkurta të liferimit.

"Osa-Termosistemi", për të gjitha prodhimet ka licencë dhe a-teste", pohon bashkëpronarja e kësaj ndërmarrjeje.

Femrat, udhëheqëse të suksesshme

Të gjitha femrat kosovare, që fatkeqësisht janë në numër të vogël, janë treguar të suksesshme në sfera të ndryshme, thotë Sadberë Osa, 55 vjeçare. "Përballë problemeve dhe sfidave të njëjta, femrat dhe meshkujt janë të barabartë në çdo sferë. Sidomos në menaxhim, femrat kanë dëshmuar se dinë të jenë shumë të suksesshme", shprehet znj.Osaj, e cila është dëshmuar si

udhëheqëse e mirë në tri vende udhëheqëse.

Ajo thotë se gjatë punës ka pasur edhe përkrahjen e familjes dhe të bashkëpunëtorëve. Megjithatë, sipas saj, duhet të rritet numri i femrave që merren me menaxhim, në mënyrë që të ndryshohet mentaliteti i përgjithshëm rreth femrave udhëheqëse.

"Në përgjithësi, në Kosovë nuk janë mësuar të shohin femra udhëheqëse, por duhet të ndryshojë ky mentalitet dhe të binden se femrat dinë të udhëheqin mirë", thekson ajo.

Çka prodhon Termosistemi

Prodhon të gjitha llojet dhe format e vitrinave ftohëse ekspozuese, vitrina ftohëse për akullore, pajisje dhe orendi për furratari, banakë për kafene dhe restorante, këmbyes, kaloriferë me rrymë dhe avull, kolektorë, solar për ngrohjen e ujit dhe të gjitha orenditë për kuzhina.



PAJISJE FISKALE PËR ÇDO BIZNES

www.gekosgroup.com

REGJISTRUESIT ELEKTRONIK FISKAL – ARKAT FISKALE

DP-50



260 €

1.000 artikuj

MP-55B EJ
325 €



MP-55B
289 €

3.000 artikuj

MP-55EJ



379 €

3.000 artikuj

DP-500 EJ



480 €

5.000 artikuj

PRINTERAT FISKAL

DATECS FP-60



449 €

2.800 artikuj

CITIZEN FP-550



680 €

30.000 artikuj

EPSON TM-T260F



1100 €

50.000 artikuj



125 €
50€ deri me datën 15 maj

Displej
per kliente

110 €

Terminal Tatimor

155 €

DISTRIBUTORËT E AUTORIZUAR

*të gjitha çmimet janë pa TVSH

PRISHTINË

NTSH "RIKON" Lagja Arbëria II, Rr. Azem Jasharica 25, tel: 044 600 111 Fax: +38138/244 285,
Printec L.L.C. Rr. Hajrullah Abdullahu nr. 9/12, tel: 044 955 211,
NTSH Enternet Rr. "Eduard Lir" p.n. tel: 038 604 059;
N.S.H. "Accounting House", rr. Fazli Grajveci, nr. 7, tel: 044/049 260 391
N.S.H.T. "Info-Telecommunication", Bregu i Diellit, rr. Armend Daci, mexhitdurmishi@yahoo.com
DAXA Electronic, Rr. Egrem Qabej, nr. 19, tel: 038 244 016; fax: 038 229 439; Mob: 044 503 183
S.T.R. NAM, Graçanicë, Glavna Ulica, tel: 063 8010687, 065 8010687, 049 677 767

PRIZREN

NTSH Remix Rr. "Jusuf Gervalla" p.n. tel: 044 140 394; 049 516 510,
D.P.SH Dekor Rr. "Haxhi Zeka" nr. 80; tel: 044 113 275; 044/049 139 796,
N.T.SH. Enternet Rr. "Shuaip Spahiu" Nr. 31, tel: 029 232 735,

FERIZAJ

IT Solution Rr. Ahmet Kaçiku (përballë Xhamisë së Madhe) tel: 044 472 203; 044 663 295-
N.T.SH. Enternet Rr. "12 Qershori" p.n. tel: 0290 396 067,
N.T.SH. EPB Rr. "Rexhep Bialimi" 101- (te Eurogoma) tel: 049 503 454, 049 173 068,

FUSHË KOSOVË

N.S.H. BALANC Rr. "Nëna Tereze"-Afer TEB Bank Fushë Kosovë tel: 044 124 280; 049 118 324 038 723 567,
N.T. MEKOLLU Rr. "Nëna Tereze" nr. 165, tel: 044 788 331; 044 248 594; 044 200 610,
N.T.SH. Enternet Rr. "Zona Industriale" p.n. tel: 038 603 230; 603 229,

PEJE

N.P.T. Dukaçinli Shop Rr. "Toni Bler" p.n. tel: 039 434 218;
N.T.SH. Enternet Rr. "Beteja e Kosharës" nr. 19, tel: 039 420 644,

GJILAN

N.P. Toni-Impex Rr. "Adem Jashari" nr. 60, tel: 044 132 635,
N.T.SH. Enternet Rr. "Skenderbeu" p.n., tel: 0280 323 323,

PODUJEVË

N.T.P. Termo-com Rr. magjistralja Prishtinë-Podujevë (përballë Agnesa) tel: 044 201 980,

KAÇANIK

SH.P.K. Burimi, Rr. "Agim Bajrami", tel: 0290 380 100; 044 486 325,

DEÇAN

N.T.P. Tropikal, Rr. "Deshmoret e Kombit" p.n., tel: 049 200 215; 044 180 479,

MITROVICË

N.T.SH. Enternet Rr. "Mretëresha Teutë" p.n., tel: 028 535 044,
N.T.SH. ADI COM Rr. "Brigada 142" tel: 049 655 909; 044 330 885,

DRENAS

SH.P.K. Granti Group, Rr. "Jasharajve" p.n., tel: 044 601 776; 045 388 333,

SUHAREKË dhe MALISHEVË

Inhalte Group, Rr. "Brigada 123" Suharekë, tel: 049 441 045; 044 393 170; 044 303 395,
Qendra të Përditësimit Kombëtare Malisheve

GJAKOVË

N.T.SH. IDEA Communication shpk, Rr. Yli Morina p.n. (përballë ProCredit Bank) tel: 044 127 526
N.T.SH. Enternet, Rr. "UÇK", nr.53, tel: 0390 320 028,

RAHOVEÇ

D.P.Z. Kamberi, rr. Xhelal Hajda-Toni, nr. 5, tel: 044/049 204 147

SHPALLJA PËR DISTRIBUTOR TË AUTORIZUAR ENDE ËSHTË E HAPUR!



Disa momente
nuk harrohen.

NLB Kredi për banim

Ato fillojnë në bankën tuaj me
NLB Kredi për banim.

NLB  Prishtina

www.nlbprishtina-kos.com

Rendimente të ulëta të grurit

Eko Biznesi

Me mbi dy javë vonesë, fushata e korrje-shirjeve ka filluar në pjesën më të madhe të Kosovës, përpos pjesës veriore të saj, e cila gjithnjë mbetet e fundit. Vonesa në fillimin e fushatës është pasojë e motit me lagështi që mbretëroi gjatë qershorit dhe fillim të korrikut. Kjo është reflektuar me pasojë në rendimentin e grurit. Kombajneri Skender Hyseni nga Shtimja, i cili po bën korrje-shirje në rajonin e Prizrenit dhe Suharekës, thotë për "Eko Biznes" se rendimenti është më i ulët se vitin e kaluar dhe po sillt rreth 3-3.5 Ton/ha. Ai thotë se kokrra e grurit ka mbetur më e vogël. Edhe kryetari i Federatës Sindikale të Bujqve të Kosovës (FSBK), Tahir Tahiri, thotë se "fatkeqësisht rendimenti është më i dobët, si pasojë e motit i cili ka ndikuar edhe në paraqitjen e sëmundjeve të grurit". Më tutje, duke folur për "Eko Biznes", Tahiri thotë se "rendimenti i ulët është pasojë e përdorimit të plehrave me kualitetit jashtëzakonisht të dobët dhe të falsifikuara". Kryesisht janë plehra dhe farëra që po vijnë nga Serbia me një kualitet të dobët, thotë Tahiri. Ndërsa, në një pjesë të komunës së Gjakovës, dëme të mëdha në rendimet ka shkaktuar edhe breshëri.

Vonohet edhe subvencionimi

Përpos vonesave në fillimin e fushatës

76 MIJË HEKTARË, 1350 AUTOKOMBAJNA

Sipas të dhënave në Ministrinë e Bujqësisë Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural, nga drejtoritë komunale, sivjet llogaritet se në tërë Kosovën me drithëra të bardha janë të mbjellë 76 mijë hektarë ndërsa janë të angazhuar për korrje-shirje rreth 1350 autokombajna. Në çdo komunë janë formuar komisionet komunale për korrje shirje që përcjellin ecurinë e fushatës dhe i raportojnë Komisionit Qendror për korrje-shirje në MBPZHR, në të cilin bëjnë pjesë edhe përfaqësuesit e Federatës Sindikale të Bujqve të Kosovës dhe ai i Shoqatës së Mulliseve të Kosovës.



së korrje-shirjeve, për shkak të shirave, një vonesë që po u shkaktonte problem kombajnerëve është vonesa në fillimin e subvencionimit të naftës, për çka Qeveria e Kosovës ka ndarë tashmë 500 mijë €.

Kombajneri Skender Hyseni, i cili ka

në pronësi 24 autokombajna thotë se, përkundër premtimeve, ende nuk kanë marrë asgjë nga Qeveria. "Për momentin, e kemi shumë gjendjen e rëndë, sepse jemi duke e blerë naftën me çmim shumë të lartë, pasi e kanë ngritur çmimin. Nga komuna vetëm i kanë marrë shënimet, i kemi plotësuar formularet dhe jemi në pritje", thotë Hyseni. Adem Arifaj, zyrtar në Departamentin e Prodhimit të Bimorë, nga

Ministria e Bujqësisë, thotë se Komisioni për shpërndarjen e subvencioneve për naftën ka hasur në problemin përcaktimit të furnizuesit për kombajnerët. Sipas tij, problemi qëndron në faktin se Ministria kërkon çmim të garantuar për një muaj, gjë që ka bërë që furnitorët të ofrojnë një çmim shumë më të lartë sesa çmimi real i tregut. "Derisa me veturë mund të furnizohesh me 1.05-1.08 €/l, për kombajnerët çmimi i naftës është ngritur në 1.15 €/l, pikërisht për faktin se ne kemi kërkuar çmim garantues për një muaj, e kjo realisht po e dëmton kombajnerin. Problem

tjetër është se Qeveria ka menduar që subvencionimin ta kryejë përmes furnizuesit të institucioneve qeveritare që është "HIB Petrol", por kjo kompani nuk e ka të shtrirë rrjetin furnizues në tërë Kosovën, gjë që ka paraqitur një problem shtesë, që duhet të zgjidhet këtyre ditëve" thotë Arifaj.

Ndryshe ai sqaron se subvencionimi është paraparë të përfshijë rreth 30% të sasisë së naftës së hanxhuar, që nënkupton se fillimisht kombajnerët duhet të furnizohet vetë, e pastaj sipas dëshmvive për hektarët e korrur edhe të subvencionohen. "E përderisa çmimi i naftës është kaq i lartë për kombajnerët krahasuar me tregun, atëherë realisht ne nuk po subvencionojmë 30% të sasisë së shpenzuar por më pak", thotë Arifaj, i cili shprehet se gjatë ditëve në vazhdim do të bëhet një zgjidhje.

Çmimi "unik" në gjithë Kosovën

Për dallim nga vitet e tjera, kryetari i Federatës Sindikale të Bujqve të Kosovës (FSBK), Tahir Tahiri, thotë se këtë vit ka pasur një bashkëpunim të mirë në mes Ministrisë, kombajnerëve dhe sindikatës, gjë që ka bërë që të arrihet një konsensus për çmimin optimal, si për fermerët, ashtu edhe për kombajnerët. "Jemi marrë vesh që çmimi për një hektar të jetë 90 euro, që sipas kalkulimeve është i pranueshëm për të dyja palët", thotë Tahiri, duke shtuar se, në këtë kalkulim është përfshirë edhe subvencionimi i naftës. Derisa kombajneri Skender Hyseni thotë se çmimi është duke u respektuar, vetë zyrtari nga Ministria e Bujqësisë, Adem Arifaj, thotë se nëse nuk arrihet që me kohë të bëhet subvencionimi dhe nëse çmimi i naftës mbetet kaq i lartë, vështirë se do të respektohet marrëveshja.

Eko Biznesi

Megjithëse Kosova ka bërë progres në përlëvizimin e disa pjesëve në pyjet e Kosovës, akoma po vazhdon tradita e vjetër që të bëhet dëmtimi i pyjeve në Kosovë. Ndonëse nuk ka ndonjë statistikë zyrtare se sa po dëmtohen pyjet në vend, sipas zyrtarëve qendrorë dhe atyre lokalë, janë duke u bërë përpjekje që të bëhet një zgjidhje për parandalimin e prerjeve ilegale të pyjeve që po dëmtohen nga qytetarëve të Kosovës. Drejtori i Departamentit për Mbrojtjen e Pyjeve në Ministrinë e Bujqësisë, Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural, Hysen Abazi, ka deklaruar për "Eko Biznes" se po bëhen përpjekje që të ketë një legjislacion që do të bëjë që pyjet në Kosovë të bëhen ashtu si duhet të jenë, sipas standardeve ndërkombëtare. "Ne po punojmë rreth amendamentit dhe plotësimit të tij, i cili pritet që të miratohet nga Parlamenti i Kosovës, më së largu,

Vazhdon shkatërrimi pyjeve



deri në fund të vitit, ashtu siç është paraparë me pakon e Ahtisaarit", tha ai, duke shtuar se ekziston nevoja për bashkëpunim dhe koordinim të të gjitha institucioneve dhe organizatave që kanë përgjegjësi mbrojtjen e pyjeve. "Duhet të koordinohen punët që kjo përfshin edhe ndarjen e përgjegjë-

sive, lehtësimin e procesit të bartjes së përgjegjësisë në nivel lokal, si dhe përmirësimin e legjislacionit", ka thënë ai. Sipas tij, duhet që të ketë më shumë sensibilizim të këtij problemi edhe në nivele më të larta të institucioneve të Kosovës. Edhe në një numër të madh të komunave ka pasur shumë

aktivitete, të cilat janë me rëndësi për mbrojtjen e pyjeve. Komunitat kanë shprehur përkushtimin dhe gatishmërinë në mbrojtjen e pyjeve.

Por komunitat kanë hasur në probleme të ndryshme, duke filluar edhe nga mungesa e pajisjeve, numrit të vogël të rojave të pyjeve, pagat e ulëta, mungesën e veturave të mjaftueshme etj. Për të përlëvizuar vendet që janë të paplylluara, Qeveria e Kosovës, në vitin e kaluar, ka filluar projektin "1 banor, një fidan".

Përderisa vjet janë mbjellë mbi dy milionë fidanë në kuadër të projektit të përlëvizimeve me moton "një banor, një fidan" që është zhvilluar nën patronatin e Kryeministrit Taçi dhe i cili projekt është tradicional. Kjo fushatë e mbjelljes së fidanëve, që tashmë është tradicional, do të vazhdojë edhe këtë vit.

Ministri i Bujqësisë, i Pyltarisë dhe i Zhvillimit Rural, Blerand Stavileci, ka theksuar se MBPZHR do të delegojë komunave përgjegjësitë që ndërlidhen me mbrojtjen e pyjeve dhe dhënien e lejeve për prerjen e trungjeve në nivel lokal. Por, edhe gjykatat po kontribuojnë në shkatërrimin e pyjeve të Kosovës. Mijëra lëndë të cilat janë iniciuar kundër prerësve ilegale të pyjeve, vazhdojnë të "flesë" nëpër sirtarët e gjykatave. Në anën tjetër, prerësit ilegale, pa ndonjë problem, vazhdojnë veprimtarinë e tyre të shkatërrimit të pyjeve.

Ndryshe, Kosova llogaritet se ka mbi 43 për qind të territorit të saj sipërfaqe me pyje, ajo akoma nuk po i shfrytëzon malet për të gjeneruar zhvillim dhe vende të reja pune, ndërsa 93 për qind të këtyre pyjeve janë gjetore dhe vetëm 7 për qind janë pishë.



Së shpejti...

bekonomike.com



Tel: +381 38 22 53 53

Fax: +381 38 22 54 54

info@bekonomike.com

 **Banka
Ekonomike**